



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office



# Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të raporteve të auditimit të performancës të vitit 2018

Prishtinë, gusht 2023

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky vlerësim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000<sup>1</sup> dhe SNISA 12<sup>2</sup>) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve është një proces përcjellës gjatë të cilit auditorët vlerësojnë përshtatshmërinë, efektivitetin dhe afatet kohore të veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti i organizatës së audituar për të adresuar çdo rekomandim të auditimit.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me raportin e auditimit për vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve “Raportet e auditimit të performancës të publikuara gjatë vitit 2018”, në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme Myrvete Gashi-Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Fatlinda Ramosaj, Drejtor i Auditimit  
Armin Bushati, Udhëheqës i ekipit

---

<sup>1</sup> Standardet për auditim të performancës (<https://www.issai.org/wp-content/uploads/2019/08/ISSAI-3000-Performance-Audit-Standard.pdf>)

<sup>2</sup> Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – veprimet drejt ndryshimeve në jetën e qytetarëve

## Tabela e përmbajtjes

|  |    |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme .....   | 5  |
| 1. Hyrje.....  | 8  |
| 2. Objektiva e vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve .....                                    | 9  |
| Pyetjet e auditimit .....  | 9  |
| 3. Niveli i zbatimit të rekomandimeve për raportet e auditimit të performancës për vitin 2018 .....        | 10 |
| 3.1 Planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit .....                                      | 10 |
| 3.2 Niveli i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve .....  | 11 |
| 3.3 Zbatimi i rekomandimeve në nivel të raporteve individuale dhe subjekteve të audituara.....             | 13 |
| 3.3.1 Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit.....                               | 13 |
| 3.3.2 Lista Esenciale e Barnave .....  | 21 |
| 3.3.3 Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal.....   | 24 |
| 3.3.4 Efektiviteti i programeve të veçanta për banim.....  | 26 |
| 3.3.5 Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit..... | 33 |
| 3.3.6 Vlera për para në prokurimet e centralizuara, Pjesa e parë.....                                      | 38 |
| 3.3.7 Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura .....           | 42 |
| 4. Konkluzionet .....  | 45 |
| Shtojca I. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia ...            | 47 |
| Motivi i Auditimit.....  | 47 |
| Pyetjet e auditimit .....  | 47 |
| Kriteret e auditimit: .....  | 48 |
| Metodologjia e Auditimit.....  | 48 |
| Fushëveprimi dhe kufizimet e këtij auditimi.....   | 49 |
| Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant.....  | 50 |
| Shtojca II. Tabela me rekomandimet për të cilat nuk kemi marrë përgjigje .....                             | 52 |

## Shkurtesat

AMMK - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

APRK - Agjencinë për punësim e Republikës së Kosovës,

AQP - Agjencia Qendrore e Prokurimit

AZhB - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

FSSh - Fondi i Sigurimeve Shëndetësore

IHMK - Instituti Hidrometeorologjik të Kosovës

INTOSAI/ONISA - Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit

ISA - Institucionet Supreme të Auditimit

MBPZhR - Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

MIE - Ministria e Integritetit Evropian

MMPHI - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

MSh - Ministria e Shëndetësisë

SNISA - Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

ShSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

ZKA - Zyra Kombëtare e Auditimit

ZKM - Zyra e Kryeministrit

PVB - Programi i Veçantë për Banim

JICA - Japan International Cooperation Agency/Agjencia Japoneze për Bashkëpunim

Ndërkombëtar

## Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit në vitin 2018 ka publikuar shtatë raporte të auditimit të performancës. Qëllimi i këtyre raporteve të auditimit të performancës ishte të vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit dhe nëse ka vend për përmirësim.

Zyra Kombëtare e Auditimit në këtë raport të vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve ka përfshirë 123 rekomandime të dhëna në shtatë raporte të auditimit të performancës, për 46 subjekte të cilat ishin të përfshira në këto auditime.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka përgatitur dhe dërguar pyetësor për shtatë raporte të auditimit të cilat janë dërguar tek 46 subjekte të përfshira në auditim. Pyetësorët e plotësuar i kanë kthyer 25 prej tyre derisa 21 subjekte të përfshira në këtë vlerësim nuk u janë përgjigjur pyetësorëve tonë pavarësisht kërkesës sonë të vazhdueshme. Kjo tregon mungesën e llogaridhënies ndaj institucioneve publike rrjedhimisht mungesën e gatishmërisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit. Lista me subjektet për auditimet e performancës që nuk u janë përgjigjur pyetësorëve (kërkesave tona për zbatim të rekomandimeve) është paraqitur në shtojcën II të këtij raporti. Kryesisht kjo ka ndodhur për raportet e auditimit të performancës **“Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal”** dhe **“Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura”**, ku kemi pranuar përgjigje nga një numër simbolik i subjekteve të audituara.

Zbatimi i disa rekomandimeve në nivel individual të subjekteve të audituara në tre nga shtatë raportet e auditimit të performancës ka ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar. Megjithatë, duke e pasur parasysh që rekomandimet për këto raporte janë dhënë në vitin 2018, pra kanë kaluar rreth pesë vite nga gjendja e konstatuar aso kohe, **angazhimet e subjekteve të audituara për të zbatuar rekomandimet e dhëna nuk janë të mjaftueshme.**

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve ka shpalosur se niveli i zbatimit të plotë të rekomandimeve për shtatë raportet e auditimit të performancës ishte 37%, ndërsa 25% e rekomandimeve janë trajtuar dhe janë në fazë të ndryshme të zbatimit të tyre ndërsa pjesa tjetër ose nuk janë zbatuar, nuk janë më të aplikueshme ose edhe nuk kemi mundur t'i vlerësojmë sepse subjektet e audituara nuk kanë kthyer përgjigje. Nga 123 rekomandime të dhëna, 45 prej tyre janë zbatuar, shtatë janë në fazën finale të zbatimit, dhjetë rekomandime janë duke u zbatuar, pesë rekomandime nuk kanë filluar të zbatohen, 14 rekomandime nuk janë më të aplikueshme për subjektet e adresuara (për 9 nga to përgjegjësitë kanë kaluar në subjekte tjera derisa pesë nuk janë të aplikueshme më), ndërsa për 42 rekomandime nuk kemi marrë përgjigje fare nga subjektet e audituara për të kuptuar nëse është marrë ndonjë veprim apo jo për zbatimin e atyre rekomandimeve.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së bashku me dy Agjencitë e saj (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës) ka bërë progres të theksuar në ndryshimin e gjendjes së evidentuar që nga publikimi i raportit **“Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit”** deri në kohën e vlerësimit të rekomandimeve. Nga 10 rekomandime adresuar kësaj Ministrie, nëntë prej tyre janë zbatuar. Zbatimi i këtyre rekomandimeve ka pasur një ndikim pozitiv në proceset e kësaj Ministrie duke përmirësuar rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më saktësisht Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës, ka shënuar progres të dukshëm në nivel individual në avancimin e operacioneve të tyre duke zbatuar 10 rekomandimet e dhëna për ta në raportin **“Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit”**, duke i bërë politikat e punësimit më efektive dhe efikase se që ishin evidentuar përmes auditimit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shënuar progres në zbatimin e rekomandimeve edhe në fushën e banimit social. Nga 15 rekomandimet e dhëna për këtë subjekt të audituar në raportin **“Efektiviteti i programeve të veçanta për banim”**, nëntë prej tyre i ka zbatuar (gjashtë tjerat janë në proces zbatimi), duke përmirësuar dukshëm proceset e lidhura me banimin social dhe duke e ngritur këtë proces në një nivel më të lartë.

**Komuna e Mitrovicës** edhe pas pesë vitesh prej se është identifikuar çështja e mos zbatimit të kontratës – nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t’u siguruar se janë ndërtuar 10 shtëpitë si kundërvlerë e tokës së dhënë në shfrytëzim nga ana e Komunës. Zyrtarët e kësaj Komune nuk ishin në gjendje të na sigurojnë asnjë dokumentacion përmes së cilit mund dëshmohet se ato shtëpi janë ndërtuar.

Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës kanë shënuar progres në krahasim me gjendjen e evidentuar në auditimin e **“Listës Esenciale të Barnave”**. Ministria e Shëndetësisë ka zbatuar tre nga katër rekomandimet e adresuara për të duke e përmirësuar kështu përmbushjen e synimeve të parapara përmes Listës Esenciale të Barnave, me theks azhurnimin e kësaj Liste për dy herë brenda kësaj periudhe.

Agjencia Qendrore e Prokurimit ka shënuar një progres të kufizuar që nga publikimi i raportit **“Vlera për para në prokurimet e centralizuara, Pjesa e parë”**, duke zbatuar plotësisht tri nga shtatë rekomandimet e dhëna, po që veprime të caktuara ka ndërmarrë edhe për dy tjera gjë që ka ndikuar deri diku në përmirësimin e proceseve operative. Në zbatim të këtyre rekomandimeve ndikim kishte edhe auditimi tjetër (pjesës së dytë) në këtë institucion.

Gatishmëria e subjekteve të audituara për të përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve nuk ishte e mjaftueshme, pasi që vetëm pesë nga 46 subjektet e audituara në vitin 2018 kanë dërguar plane të veprimit për zbatim të rekomandimeve. Mos përgatitja e planeve të veprimit (mos prioritizimi i zbatimit të rekomandimeve) si dhe mos përgjigja ndaj kërkesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit për të mundësuar vlerësimin e masave të

ndërmarra për rekomandimet e dhëna tregon mungesën e llogaridhënies së subjekteve të audituara për të përmirësuar cilësinë e performancës së tyre dhe mënyrës se si menaxhojnë me paranë publike. Këtu vlen të përmendet fakti se disa subjekte të audituara edhe pse nuk kanë dorëzuar plane të veprimit, gjatë këtij vlerësimi kemi evidentuar se janë ndërmarrë veprime për zbatim të rekomandimeve.

### **Rekomandimet për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kryetarët e Komunave:**

Të luajnë një rol proaktiv duke trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me gjetjet e auditimeve të performancës. Këto të fundit të vendosin mekanizma llogaridhënës që:

- Të përgatisin planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit dhe t'i dërgojnë ato te Zyra Kombëtare e Auditimit jo më vonë se 30 ditë pas pranimit të raportit final të auditimit; dhe
- Kërkesave për dokumente mbështetëse për qëllime auditimi apo edhe vlerësimi drejtuar subjekteve t'i përgjigjen me kohë Zyrës Kombëtare të Auditimit.

# 1. Hyrje

Institucionet Supreme të Auditimit (ISA-të) luajnë rol jetik në rritjen e llogaridhënies nga Institucionet publike në raport me administrimin e fondeve publike. Përveç kësaj, këto të fundit ndihmojnë edhe në ngritjen e transparencës së aktiviteteve të qeverisë.

Qëllimi i vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve është t'u ofrojë informacione të pavarura Qeverisë, Kuvendit të Kosovës dhe palëve të tjera të interesit lidhur me masat e ndërmarra nga subjektet e audituara për zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Përveç kësaj, vlerësimi shërben si një orientim për Zyrën Kombëtare të Auditimit në kuptimin e nivelit të zbatimit dhe ndikimit të saj përmes raporteve të auditimit të performancës.

Qëllimi kryesor i Zyrës Kombëtare të Auditimit nuk përfundon me publikimin e raportit të auditimit por me vlerësimin e ndikimit të aktivitetit auditues në përmirësimin e menaxhimit të parasë publike.

Pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, prej subjektit të audituar kërkohet që të hartoj një plan të veprimit ku specifikohen veprimet që do të ndërmerren, koha dhe mënyra e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Qëllimi i rekomandimeve në auditimet e performancës është përmirësimi i proceseve të ndryshme dhe funksionimit efektiv të sistemeve, programeve dhe aktiviteteve qeveritare. Rekomandimet u adresohen subjekteve të audituara dhe zbatimi i tyre shërben si mekanizëm për tejkalimin e dobësive dhe bërjen e sistemeve më efikase, ekonomike dhe efektive në arritjen e objektivave.

Pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, aktivitetet përcjellëse kontribuojnë në zbatimin më efektiv të rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara. Synimi i vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve është që të përcaktohet nëse me veprimet e ndërmarra është shënuar progres në krahasim me gjendjen e konstatuar gjatë auditimeve.

Pasi që shumica e rekomandimeve të auditimit të performancës kërkojnë kohë për t'u zbatuar, vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të performancës duhet të ndërmerret pas një periudhe të caktuar kohore.

Përmes këtij raporti janë vënë në pah rezultatet në procesin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës. Në këtë mënyrë janë vlerësuar rezultatet e subjekteve në realizimin e objektivave në përputhje me parimet e menaxhimit efektiv.



## 2. Objektiva e vlerësimit të nivelit të zbatimit të rekomandimeve

Standardet e auditimit kërkojnë që pas publikimit të raportit të auditimit të performancës të zbatohet një proces i vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve për të konkluduar nëse auditimi ka arritur rezultatin e synuar dhe të sigurohet se planet e veprimit janë zbatuar në mënyrë efektive<sup>3</sup>.

Objektivë e këtij auditimi është të vlerësojmë nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimeve të performancës të kryera gjatë vitit 2018 dhe nëse këto të fundit kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së identifikuar përmes auditimit.

### Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit, kemi formuluar pyetjet në vijim:

- 1. A janë dërguar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe a janë zbatuar rekomandimet nga subjektet e audituara?**
- 2. A kanë arritur rekomandimet rezultatin e synuar të përmirësimit të gjendjes në subjektin e audituar?**

Ky vlerësim i nivelit të zbatimit të rekomandimeve për bazë kishte raportet e auditimit të performancës të publikuara në vitin 2018. Në këto auditime janë përfshirë 46 institucione publike, prej të cilave 19 i takojnë nivelit lokal (komunave), 25 të nivelit qendror (Ministri dhe Agjenci të pavarura) dhe dy ndërmarrje publike.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi, nën-pyetjet e auditimit kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i detajuar i auditimit janë paraqitur në Shtojcën 1.

---

<sup>3</sup> SNISA 300, [www.issai.org](http://www.issai.org), Performance Audit Principles, INTOSAI Standards

### 3. Niveli i zbatimit të rekomandimeve për raportet e auditimit të performancës për vitin 2018

Në këtë kapitull kemi paraqitur vlerësimin për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës të cilat janë publikuar gjatë vitit 2018. Fillimisht është paraqitur niveli i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve, pasuar me përshkrimin e gjendjes së rekomandimeve të dhëna për raport individual të auditimit të performancës dhe subjektit të audituar. Përveç kësaj, është trajtuar dhe çështja lidhur me mungesën e planit të veprimit. Me anë të pyetësorëve të dërguar si dhe analizës së tyre, dëshmime të dërguara, takimeve, vizitave në terren kemi vlerësuar gjendjen aktuale në institucionet përkatëse, si dhe nivelin e adresimit/zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Ndërsa në shtojcën II të këtij raporti janë paraqitur edhe rekomandimet për të cilat ZKA-ja nuk ka pranuar përgjigje.

#### 3.1 Planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditimit

*Pas publikimit të raportit të auditimit subjektet e audituara duhet të hartojnë planet e veprimit (aktiviteteve) për zbatim të rekomandimeve të dhëna dhe të sigurohen se ato zbatohen sipas afateve kohore të specifikuara në plan.*

Hartimi i planit të veprimit tregon gatishmërinë e subjekteve të audituara që të marrin përsipër obligimet që i takojnë për të zbatuar rekomandimet dhe si rrjedhojë të përmirësojnë aktivitetet apo programet e tyre qeveritare.

Në tabelën e mëposhtme janë shpalosur raportet e auditimit dhe informatat e përgjithshme se për cilat raporte janë dorëzuar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

**Tabela 1 Dorëzimi i planeve të veprimit për raportet e auditimit të performancës**

| <i>Auditimet e Performancës</i>   | <b>Plani i veprimit</b> |           |
|---|-------------------------|-----------|
|   | <b>PO</b>               | <b>JO</b> |
| Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit                               |                         | √         |
| Lista Esenciale e Barnave   | √ <sup>4</sup>          |           |
| Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal   | √ <sup>5</sup>          |           |
| Efektiviteti i programeve të veçanta për banim  | √ <sup>6</sup>          |           |
| Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit |                         | √         |
| Vlera për para në prokurimet e centralizuara – Pjesa e parë                                     |                         | √         |
| Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura            | √ <sup>7</sup>          |           |

Siç shihet nga tabela më lartë, nuk janë dorëzuar plane të veprimit për të gjitha auditimet që janë përfshirë në këtë vlerësim, qe për më tepër të gjitha këto auditime kishin më shumë se

<sup>4</sup> Plan veprimi ka dorëzuar Ministria shëndetësisë për të gjitha rekomandimet (përfshirë ato për FSSH dhe ShSKUK)

<sup>5</sup> Pjesërisht – Planin e Veprimit e ka dorëzuar vetëm MAPL dhe MF

<sup>6</sup> Pjesërisht - Planin e Veprimit e ka dorëzuar vetëm MMPH

<sup>7</sup> Pjesërisht - Planin e Veprimit e ka dorëzuar vetëm MIE dhe MSh

një subjekt të audituar. Për katër raporte të auditimit të performancës janë dorëzuar plane të veprimit nga disa institucione që ishin subjekt i auditimit, derisa për tri raporte të auditimit nuk janë dorëzuar plane veprimi fare.


Pavarësisht se është kërkesë ligjore, 27 subjekte të audituara nuk kishin dorëzuar plan të veprimit. Mos dorëzimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, sjellë pasiguri për gatishmërinë e subjekteve për të përmirësuar gjendjen në institucionet e tyre. Megjithatë, vlen të përmendet se disa subjekte të audituara, përkundër faktit që nuk kanë dorëzuar plane të veprimit, ata kanë ndërmarrë veprime për t'i zbatuar ato.

### 3.2 Niveli i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve

Auditimet e publikuara në vitin 2018 kanë mbuluar fushat në vijim: punësim, shëndetësi, administratë publike (me fokus nivelin lokal), çështje sociale, ato të mjedisit (me fokus cilësinë e ajrit) dhe prokurimet e centralizuara.

Në grafikun më poshtë është paraqitur numri i rekomandimeve të zbatuara pasuar me numrin e rekomandimeve të cilat mbesin për t'u zbatuar në nivel të shtatë raporteve të auditimit të performancës.

Grafiku 1 Niveli i zbatimit të rekomandimeve për shtatë raporte të auditimit




Siç shihet në grafikun më lartë, rekomandime për të cilat kemi pranuar përgjigje dhe janë trajtuar janë 81<sup>8</sup>. Nga ky numër, 45 rekomandime janë zbatuar, 31 rekomandime kanë mbetur për zbatim derisa pesë më nuk janë të aplikueshme. Për 42 rekomandime ne nuk

<sup>8</sup> Këtu përfshihen rekomandimet e zbatuara, të mbetura për zbatim dhe ato të cilat nuk janë të aplikueshme

ishim në gjendje të sigurojmë të dhëna nëse subjektet e audituara kanë marrë ndonjë veprim për zbatimin e tyre.

Në grafikun më poshtë kemi paraqitur përqindjen e zbatimit të rekomandimeve sipas fushave të trajtuara në auditimet e performancës të publikuara gjatë vitit 2018. Këto auditime ishin të fokusuara në gjashtë fusha, siç janë: Prokurimi, Mjedisi, çështje Sociale, Punësim, Shëndetësi dhe Administratë Publike.

Grafiku 2 Niveli i zbatimit të rekomandimeve sipas fushave të audituara




Fusha e mjedisit dhe punësimit qëndrojnë shumë më mirë në zbatimin e rekomandimeve krahasuar me fushën e shëndetësisë apo atë të administratës publike.

Mos përgjigja me kohë në pyetësorët e dërguar nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) por edhe ri-strukturimi i shumë institucioneve brenda kësaj periudhe ka rezultuar me një numër prej 21 të rekomandimeve për të cilat nuk dihet nëse janë zbatuar apo jo. Vlen të theksohet se niveli qendror ishte më i përgjegjshëm në dërgim të përgjigjeve në pyetësorë, derisa niveli lokal dhe disa nga ndërmarrjet publike përkundër insistimeve të shumta, nuk kanë dërguar përgjigje fare.

### 3.3 Zbatimi i rekomandimeve në nivel të raporteve individuale dhe subjekteve të audituara

Në vijim është paraqitur vlerësimi i rezultateve për secilin auditim të performancës përfshirë edhe subjektin e audituar. Vlen të theksohet se rekomandimet janë trajtuar sipas renditjes, ashtu siç janë dhënë në raportet individuale. Brenda në kuti është përshkruar teksti i rekomandimit të dhënë në raportin përkatës. Ngjyrat në kutitë më poshtë paraqesin nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

#### Legjenda




#### 3.3.1 Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit

Një ndër mesazhet kyçe të këtij auditimi të performancës ishte që **“Politikat e punësimit në nivel qeveritar dhe sektorial nuk janë efikase dhe efektive”** pasi që procesi i planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave të punësimit, si në nivel qeveritar ashtu edhe në atë sektorial, është karakterizuar me mangësi të shumta, të cilat kanë ndikuar që të mos arrihet promovimi dhe rritja e punësimit.

Si rezultat i gjetjeve në këtë raport të auditimit të performancës, ZKA kishte dhënë 26 rekomandime. Siç shihet edhe në Grafikon 3 më poshtë, rekomandimet janë dhënë për pesë subjekte të audituara të cilat i takojnë nivelit qendror.

Grafiku 3 Subjektet e audituara dhe numri i rekomandimeve të dhëna për fushën e punësimit<sup>9</sup>



<sup>9</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë

Nga rekomandimet e dhëna në raportin “Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit”:

- 15 rekomandime janë zbatuar plotësisht;
- Tri rekomandime janë në fazën finale të zbatimit;
- Tri rekomandime janë në fazën fillestare të zbatimit; dhe
- Pesë rekomandime nuk janë më të aplikueshme (për më gjerësisht janë trajtuar tek subjekti përkatës)<sup>10</sup>.

### Rekomandimet për Zyrën e Kryeministrit

Zyra e Kryeministrit (ZKM) ka ndërmarrë veprime për të adresuar të gjitha (pesë) rekomandimet e dhëna në raportin e lartcekur të auditimit të performancës. Nga këto pesë rekomandime, dy rekomandime tashmë janë zbatuar, një rekomandim është në fazën finale të zbatimit, ndërsa për dy rekomandime tjera, ZKM-ja ka filluar zbatimin në qershor të vitit 2023.

Megjithëse nuk kishte një plan veprimi të hartuar paraprakisht dhe si rezultat nuk kishte priorizim, ZKM-ja ka ndërmarrë veprime për t'iu përgjigjur gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit të auditimit.

|  |                             |
|--|-----------------------------|
| <b>Rekomandimi 1:</b> Të sigurohet se prioritetet dhe dokumentet strategjike qeveritare janë të bazuara në analiza të mirëfillta për çështjen e punësimit përfshirë edhe vlerësimin e ndikimit financiar në mënyrë që ato të jenë lehtë të zbatueshme dhe të kenë qëndrueshmëri. | Në fazën finale të zbatimit |
|--|-----------------------------|

Pas publikimit të raportit të lartcekur, ZKM-ja ka ndërmarrë veprime për të përcaktuar prioritetet dhe dokumentet strategjike, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre. Ky veprim ka përfshirë analizën e kostos dhe vlerësimin të ndikimit financiar.

ZKM-ja kishte bërë analiza për të gjithë sektorët e politikave publike, përfshirë këtu edhe çështjet që lidhen me punësim, për të përkufizuar gjendjen aktuale dhe sfidat në këtë fushë. Këtë qasje e kishte reflektuar edhe gjatë hartimit të Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim 2030.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 2:</b> Të sigurohet se prioritetet dhe dokumentet strategjike kanë ndarje të qartë të objektivave dhe përgjegjësi për institucionet përgjegjëse për çështjen që ndërlidhen me punësim. | Është zbatuar |
|---|---------------|

ZKM-ja kishte siguruar ndarje të qartë të objektivave dhe përgjegjësi. Qasja për përgatitjen e Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZh) sipas zyrtarëve përgjegjës është bazuar në konceptin e sistemit të planifikimit të zhvilluar në Kornizën për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik (KPMS). Kjo kornizë përcakton elementet kryesore të reformës së sistemit të planifikimit, duke përfshirë ndarjen sipas hierarkisë së qëllimeve, treguesit e performancës, dhe përcaktimin e sektorëve. Nëpërmjet KPMS, ZKM-ja ka vendosur në funksion një qasje më

<sup>10</sup>Një rekomandim për AZhB dhe katër rekomandime për MBPZHR nuk janë të aplikueshme për këto subjekte

konsistente ndaj menaxhimit të politikave publike dhe shpërndarjes së burimeve në nivel strategjik.

Me këto veprime, ZKM-ja siguron strukturë më të organizuar dhe të qartë për planifikimin strategjik, duke përdorur KPMS si mjet lehtësues për të përcaktuar qëllimet e politikave publike dhe për të monitoruar dhe raportuar mbi realizimin e tyre.

**Rekomandimi 3:** Të sigurohet që në dokumente strategjike siç është Strategjia Kombëtare për Zhvillim çështja e punësimit të përmbajë objektiva dhe aktivitete të qarta dhe të matshme për krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe të identifikohen institucionet përgjegjëse për realizimin e tyre. Implementimi i këtij rekomandimi do të ndihmonte ZKM që të parandalonte kryerjen e aktiviteteve të dyfishta institucionale për të njëjtin qëllim si dhe do të qartësonte se cilat ministri të linjës janë përgjegjëse për aspektet e ndryshme të përmbushjes së politikës së punësimit.

Është zbatuar

Me aprovimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim, ZKM-ja kishte përcaktuar objektiva dhe veprime për politikën e punësimit, duke përfshirë edhe institucionet përgjegjëse për realizimin e tyre. Më tutje, si pjesë e elementeve hierarkike të kornizës strategjike të vendit, në proces të hartimit është edhe Strategjia e veçantë e punësimit dhe tregut të punës, e cila do të mundësojë që në mënyrë më të qartë të definojë prioritetet e punësimit në Republikën e Kosovës duke përfshirë edhe ndarjen e përgjegjësive institucionale.

**Rekomandimi 4:** Të sigurohet se mekanizmat monitorues analizojnë në detaje arritjen e objektivave që ndërlidhen me punësim nga ministrinë e ndryshme që kanë përgjegjësi këtë objektivë.

Ka filluar zbatim

ZKM-ja është në fazat fillestare të zbatimit të këtij rekomandimi pasi që koncepti i Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim mundëson vendosjen e një sistemi të mirëfilltë të monitorimit dhe raportimit të politikave, përmes treguesve të ndikimit, të rezultateve dhe treguesve të produkteve. Por, ky sistem është në ndërtim e sipër dhe efektet e tij pritet të shihen në një të ardhme të afërt, marrë parasysh që strategjia është aprovuar në mars të vitit 2023.

**Rekomandimi 5:** Të sigurohet se mekanizmat monitorues përpilojnë raporte përmbledhëse dhe analitike që tregojnë për rezultatet e arritura në aspekt të çështjeve të punësimit, ngecjet e identifikuar si dhe hapat për përmirësimin e tyre.

Ka filluar zbatim

Siç është cekur më lartë, sistemi i monitorimit dhe raportimit është në ndërtim e sipër dhe në momentin që ky sistem vihet plotësisht në funksion, atëherë mundësohet nxjerrja e raporteve përmbledhëse për të gjithë sektorët me të dhëna në bazë të treguesve të performancës për të paraqitur të arriturat dhe sfidat në zbatimin e prioriteteve.

### Rekomandimet për ish-Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (pas strukturimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) - (MFPT) ka ndërmarrë veprime për të gjitha gjashtë rekomandimet e dhëna në raportin e lartcekur të auditimit të performancës, përkundër që nuk kishte hartuar plan veprimi dhe nuk kishte një proces prioritizimi të veprimeve për të zbatuar rekomandimet e

dhëna. Nga këto rekomandime, pesë rekomandime tashmë janë zbatuar, ndërsa për një rekomandim, MFPT ka filluar me zbatim.

|   |                   |
|---|-------------------|
| <b>Rekomandimi 6:</b> Të rishikohen dokumentet kryesore sektoriale dhe ato të brendshme, në veçanti për të rregulluar statusin e disa prej masave aktive të tregut të punës, sidomos aspekti i mos konsiderimit të masës praktikë në punë si punësim dhe çështja e rregullimit të prioritizimit të të papunëve afatgjatë. | Ka filluar zbatim |
|---|-------------------|

MFPT ka filluar të marrë veprime në këtë drejtim duke bërë që Rregullorja e Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP) t'i nënshtrohet plotësim/ndryshimeve përmes së cilave masat trajtohen konform ligjeve në fuqi siç janë ligji i punës dhe ligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve për punëkërkuar, të papunë dhe punëdhënës.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 7:</b> Të shqyrtohet buxheti aktual dhe të krahasohet me nevojat reale të të papunëve për MATP dhe të konsiderohet mundësia për të alokuar një buxhet i cili do të përmbushte më mirë këto nevoja. | Është zbatuar |
|---|---------------|

Ky rekomandim është zbatuar nga ana e MFPT pasi që kjo e fundit kishte rritur buxhetin për këtë kategori. Që nga publikimi i raportit, buxheti i MFPT për mbështetje të punësimit, pasqyron trend të rritjes.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 8:</b> Të konsiderohet heqja e pushimit të lehonave nga buxheti që alokohet për punësim me qëllim të zhvendosjes së kësaj kategorie në një linjë të pavarur ku nuk ndikohet buxheti i MATP. | Është zbatuar |
|--|---------------|

MFPT për të zbatuar këtë rekomandim ka krijuar zë të veçantë ekonomik që mbështet buxhetin e pagesave të pushimit të lehonisë duke e hequr pushimin e lehonave nga buxheti i cili alokohet për punësim.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 9:</b> Të krijohen mekanizma për analizimin e implikimeve financiare para dhe gjatë realizimit të marrëveshjeve në buxhetin në dispozicion dhe të bëhet planifikimi buxhetor duke i marrë parasysh këto. | Është zbatuar |
|---|---------------|

MFPT ka krijuar si mekanizëm, ku zyrtarët përgjegjës kanë praktikë që çdo fillim vit të bëjnë planifikimin buxhetor për MATP. Ky planifikim bëhet duke u mbështetur në dokumentet strategjike dhe planet e veprimit që janë përgatitur më parë.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 10:</b> Të analizohen në mënyrë të vazhdueshme raportimet që bëhen nga ana e APRK, si dhe të dokumentohet në të shkruar përmes raporteve përmbledhëse progresi i arritur nga APRK lidhur me objektivat që ata kanë, si dhe të jepen sugjerime në ato raporte për përmirësimet apo azhurnimet e mundshme që duhen bërë atëherë kur është e nevojshme. | Është zbatuar |
|---|---------------|

MFPT këtë rekomandim e kishte zbatuar duke hartuar në baza vjetore një raport të performancës **“Punësimi dhe Aftësimi Profesional”** ku edhe pasqyron progresin e arritur kundrejt objektivave të përcaktuara. MFPT matjen e tyre e bën sipas planit të veprimit. Rekomandimet të cilat dalin nga raporti kanë të bëjnë me matjen e efektit të masave aktive të tregut të punës.



|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 11:</b> Të rregullohet aspekti i kryerjes së obligimeve tatimore dhe kontributeve pensionale për financimet që u bëhen MATP. | Është zbatuar |
|---|---------------|

MFPT për këtë rekomandim sikurse edhe për rekomandimet tjera kishte ndërmarrë hapa konkret dhe tashmë për disa masa (subvencionim në pagë dhe vetëpunësim) i përgjigjen obligimeve tatimore dhe kontributeve pensionale ndërsa për masat tjera (praktika në punë, trajnim në punë) nuk procesohen obligime tatimore pasi që klienti përfiton kompensim mujor (me të mbulohen shpenzimet ditore për transport dhe ushqim).

### Rekomandimet për Agjencinë për Punësim të Republikës së Kosovës

Agjencia për Punësim të Republikës së Kosovës (APRK) ka ndërmarrë veprime për të gjitha pesë rekomandimet e dhëna në këtë raport të auditimit të performancës. Të gjitha rekomandimet janë zbatuar tashmë por ky zbatim nuk ishte bërë duke u bazuar në plan të hartuar veprimi dhe APRK nuk kishte ndjekur ndonjë proces prioritizimi të zbatimit të rekomandimeve, pasi që as nuk kishte përgatitur një plan të tillë.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 12:</b> Të kryhet profilizimi në bazë të rrezikut të të papunëve në sistem për ata që ende nuk e kanë statusin e profilizuar. | Është zbatuar |
|--|---------------|

Vendosja e një fushe të re në Sistemin e Informatave të Menaxhimit të Punësimit të Kosovës (SIMPK) për filtrimin e profileve të të papunëve është hapi të cilin e kishte ndërmarrë APRK drejt përmirësimit të procesit të profilizimit. Ky hap është bërë pjesë integrale e qasjes së re të ofrimit të shërbimeve të punësimit. Profilizimi apo segmentizimi i punëkërkuarit, është procedurë e identifikimit dhe caktimit në kategori të ndryshme, në mënyrë që të dallohen ata punëkërkuar që mund të gjejnë punë më lehtë nga ata të cilët kanë më shumë vështirësi në tregun e punës.

Rezultatet e profilizimit bëhen në mënyrë automatike nga SIMPK duke u bazuar në vlerësimin fillestar të klientit. Profilizimi do të informojë zyrtarin/en për punësim në lidhje me trajtimin e duhur për punëkërkuarin.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 13:</b> Të përpilohen lista të gjera të të papunëve potencial, që nënkupton që punëdhënësit t'i ofrohet një listë me numër të kandidatëve potencial që është dy herë më i lartë se numri i kërkuar nga punëdhënësi. Implementimi i këtij rekomandimi mundëson dhënie e mundësive të barabarta për një numër më të madh të të papunëve që janë aktiv dhe të regjistruar në sistemin e APRK. | Është zbatuar |
|---|---------------|

APRK-ja në fund të majit të vitit 2023 kishte marrë vendim për aprovim të manualeve për MATP-të ku ndryshim plotësimi i janë nënshtruar tri manuale operacionale: ai për praktikë në punë, trajnim në punë si dhe subvencionim në pagë. Në këto manuale, është reflektuar ndryshimi përmes së cilit punëdhënësit i ofrohet një listë me numër më të madh të papunëve (për një pozitë së paku 3 kandidatë potencial). Ne kemi parë raste kur manuali është zbatuar dhe numri i kandidatëve të dërguar ishte në përputhje me rekomandimin.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 14:</b> T'u jepet prioritet gjatë zbatimit të MATP, të papunëve afatgjatë. | Është zbatuar |
|---|---------------|

Kategoria “të papunët afatgjatë” përfshin individët që janë të papunë për më shumë se 12 muaj dhe janë aktivë në kërkimin e punës. Në procesin e ndërmjetësimit, punëdhënësi zgjedh kandidatët sipas profesionit, kualifikimit dhe vendbanimit. Prioritizimi gjatë zbatimit të MATP-ve tashmë zbatohet sidomos për masat/skemat si në vijim: skemën për të rinjtë, skemën “Punësimi i Grave” dhe skemën “Qeveria për Familje”.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 15:</b> Të intensifikohet bashkëpunimi me ATK-në për shkëmbimin e të dhënave që ndërlidhen me çështjet e punësimit. | Është zbatuar |
|--|---------------|

APRK-ja ka ndërmarrë hapa drejt integritit të sistemeve të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC). Ky ndërveprim është intensifikuar si rezultat i pandemisë në kontekstin e përgatitjes së pakos për ringjallje ekonomike nga Qeveria e Kosovës, veçanërisht MFPT, për të përballuar sfidat ekonomike pas pandemisë.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 16:</b> Të finalizohet procesi i monitorimit të efektivitetit të MATP sa më shpejtë që është e mundur si dhe të përpilohet raport i detajuar lidhur me gjetjet e këtij monitorimi. | Është zbatuar |
|---|---------------|

Organizata GIZ, mbështetur nga Qeveria Gjermane kishte bërë një hulumtim me kërkesë të APRK-së si pjesë përbërëse e aktiviteteve të rregullta për monitorim dhe vlerësim, me fokus kryesor vlerësimin e efikasitetit të MATP-ve në Kosovë gjatë periudhës 2019 – 2021. Ky raport i hartuar në vitin 2022 përmban gjetje të detajuara lidhur me secilin MATP përfshirë edhe konkluzionet dhe rekomandime për secilën masë të vlerësuar.

### Rekomandimet për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) ka ndërmarrë veprime konkrete për dy nga gjashtë rekomandime të dhëna në këtë raport të auditimit të performancës. Nga gjashtë rekomandimet e dhëna, MBPZHR-ja për katër rekomandime ka theksuar se nuk janë të zbatueshme për të.

As MBPZHR-ja sikurse subjektet tjera pjesë e këtij auditimi nuk kishte hartuar plan veprimi dhe nuk kishte proces prioritizimi të zbatimit të rekomandimeve.

|   |                            |
|---|----------------------------|
| <b>Rekomandimi 17:</b> Të krijohet një metodologji e përshtatshme për kriterin e krijimit të vendeve të reja të punës duke marrë parasysh nevojat reale të fermerëve duke përfshirë edhe pozitat që nuk lidhen me prodhimin. Kjo metodologji duhet të gjenerojë numra të plotë për vende pune, lehtësisht të matshëm dhe të kuptueshëm edhe për fermerët. | Nuk është më i aplikueshëm |
|---|----------------------------|

Sipas zyrtarëve të MBPZHR-së, ky rekomandim nuk është më i aplikueshëm për shkak se sipas tyre objektiva kryesore e PZHR-së është rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit. Krijimi i vendeve të punës nuk është objektiv kryesor e PZHR-së por kriter i përzgjedhjes që promovon dhe orienton projektet për të krijuar vende pune (punësimin dhe vetëpunësimin).

**Rekomandimi 18:** Të fuqizohet kriteri i krijimit të vendeve të reja të punës përmes rishikimit të UA që bëjnë rregullimin dhe përcaktimin e kontrolleve dhe monitorimit të kriterëve të masave 101, 103 dhe 302.

Është zbatuar

Sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) është përgjegjëse për të kryer kontrolle ex-post dhe për verifikimin e të gjitha projekteve të përzgjedhura për financim për tre vite, e që gjatë këtij procesi bëhet edhe verifikimi i numrit të punëtorëve së bashku me obligimet që dalin për të punësuarit.

**Rekomandimi 19:** Të konsiderohet rishikimi i kërkesës lidhur me dëshmitë e kërkuara për autorizim të pagesave. Në këtë rast, nga përfituesit të kërkohet që edhe për muaj paraprak të sjellin fletëpagesat dhe listat e punëtorëve që lëshohen nga ATK.

Nuk është më i aplikueshëm

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 16/2019 përfituesit të cilët kanë deklaruar se do të krijojnë vende pune dhe se për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit duhet të krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributeve pensionale dhe tatimin në pagë duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesë. Sipas zyrtarëve të MBPZHR-së nuk mund të kërkohen fletë pagesat paraprake, sepse para kërkesës për pagesë, përfituesi është ende duke zbatuar projektin dhe nuk ka krijuar vende të punës.

**Rekomandimi 20:** Të konsiderohet ri-integrimi i kërkesës për dëshmitë e vendeve të krijuara të punës për përfituesit e masës 101 para autorizimit të pagesave.

Nuk është më i aplikueshëm

Sipas zyrtarëve të MBPZHR-së, Udhëzimi Administrativ i lartcekur specifikon kohën kur duhet të fillohet me pagesën e kontributeve pensionale dhe tatimin në pagë. Pra dëshmitë për vendet e krijuara të punës për përfituesit është e pamundur të kërkohen para autorizimit të pagesave.

**Rekomandimi 21:** Të konsiderohet ri-integrimi i kërkesës për monitorimin e mbajtjes së vendeve të krijuara të punës për përfituesit e masës 101 pas investimit.

Nuk është më i aplikueshëm

Siç është cekur më lartë, AZhB-ja gjatë kryerjes së kontrolleve ex-post për verifikimin e të gjitha projekteve të përzgjedhura për financim tre vite, nga dita e ekzekutimit të pagesës, bën edhe verifikimin e numrit të punëtorëve me obligimet që dalin për të punësuarit.

**Rekomandimi 22:** Të konsiderohet përfshirja e dispozitave në UA që parashohin masa ndëshkuese për ata përfitues që nuk i përmbahen krijimit të vendeve të punës sipas deklarimeve që kanë bërë në planet e tyre të biznesit.

Është zbatuar

Udhëzimi Administrativ nr. 16/2019 parashih sanksionet dhe ndëshkimet të cilat janë të përcaktuara në nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L -098 për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural. Në rast të shkeljes së dispozitave të lartpërmendur, AZhB-ja duhet menjëherë të informoj palën për shkelje të kontratës dhe zyra ligjore e AZhB-së duhet të filloj procedurat ligjore sipas Kodit të Procedurës Penale.

## Rekomandimet për Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) ka ndërmarrë veprime konkrete për tri nga katër rekomandime të dhëna në këtë raport të auditimit të performancës. Një rekomandim nuk është i aplikueshëm për momentin për këtë subjekt të audituar.

AZhB-ja sikurse edhe subjektet tjera pjesë e këtij auditimi nuk kishte hartuar plan veprimi dhe nuk kishte proces prioritizimi të zbatimit të rekomandimeve.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 23:</b> Të intensifikojë bashkëpunimin me Autoritetin Menaxhues, sidomos në aspektin e shkëmbimit të rregullt të të dhënave, me qëllim të përmirësimit të proceseve të planifikimit dhe monitorimit | Është zbatuar |
|--|---------------|

AZhB-ja tashmë në mënyrë të rregullt bën shkëmbimin e të dhënave të kërkuara nga Autoriteti Menaxhues në secilën fazë të paraparë për zbatim të PZhr-së.

|  |                         |
|--|-------------------------|
| <b>Rekomandimi 24:</b> Të sigurohet që të dhënat e zbatimit të masave 101, 103 dhe 302 që kanë të bëjnë me krijimin e vendeve të reja të punës, të integrohen në bazën e të dhënave me kohë, të përfshijnë të gjitha fazat e zbatimit të masave, si dhe të jenë të harmonizuara me raportet manuale. | Nuk është i aplikueshëm |
|--|-------------------------|

Sipas zyrtarëve të AZhB-së ky rekomandim nuk është i aplikueshëm për momentin, pasi që ky proces zbatohet vetëm me rastin e aplikimit, ku te indikatorët, aplikuesi deklaron numrin e krijimit të vendeve të reja të punës si rezultat i zbatimit të projektit. Mirëpo, me rastin e miratimit dhe autorizimit të projektit mungon funksionalizimi i indikatorëve i cili do të mundësonte që të dihet numri i saktë i vendeve të reja të punës.

Për t'u realizuar aktiviteti lidhur me bazën e të dhënave, së pari duhet të funksionalizohet sistemi i menaxhimit të indikatorëve. E për funksionalizimin e tij dhe zbatimin e këtij rekomandimi duhet të zhvillohet ky sistem i cili do të kishte edhe implikime buxhetore.

|  |                             |
|--|-----------------------------|
| <b>Rekomandimi 25:</b> Të përpilohet një plan konkret në të cilin do të rregullohet inicimi i monitorimit ex-post të masave të PBZHR. Në plan të specifikohen përfituesit e masave të cilët duhet t'i nënshtrohen monitorimit sipas vitit të përfitimit, afatet konkrete kohore të kryerjes së këtij monitorimi dhe sigurimi se përfituesit janë duke iu përmbajtur kriterit të krijimit të vendeve të reja të punës. Monitorimi ex-post të fillojë sa më shpejtë që është e mundur. | Në fazën finale të zbatimit |
|--|-----------------------------|

Kontrolli Ex-Post është proces që zbatohet për programet e vitit 2018 dhe 2019. Për Programin e vitit 2020/2021, kontrolli do të kryhet në vitin 2024. Procedura e kontrollit varet nga afati i paraparë me Udhëzim Administrativ. Ky kontroll kryhet në bazë të Planit të Hartuar si parapërgatitje për Kontroll Ex-Post. Përfituesit të cilët kanë paguar pjesërisht ose nuk kanë paguar kontributet fare, u është ofruar një mundësi për të paguar kontributet brenda 30 ditëve. Shumica e përfituesve kanë përmbushur kërkesën për pagesë dhe procedura është mbyllur për ta. Përfituesit që nuk kanë paguar kontributet janë kërkuar të kthejnë fondet dhe është ngritur procedura gjyqësore për mos përmbushje të obligimeve kontraktuale.

|   |                             |
|---|-----------------------------|
| <b>Rekomandimi 26:</b> Të intensifikohet bashkëpunimi dhe komunikimi me ATK-në dhe institucione tjera relevante në mënyrë që të bëhet shkëmbimi i të dhënave në lidhje me punësimin dhe si rezultat punësimet të reflektohen te të gjitha institucionet relevante dhe të rritet legjitimiteti në këtë aspekt. | Në fazën finale të zbatimit |
|---|-----------------------------|


AZhB-ja ka ndërmarrë veprime në këtë drejtim dhe atë pos kontakteve të kohëpaskohshme (për raste të veçanta), e njëjta ka iniciuar edhe memorandum bashkëpunimi për shkëmbim të të dhënave. Ky memorandum është në formë drafti.

### 3.3.2 Lista Esenciale e Barnave

Një nga rezultatet e auditimit të performancës “*Lista Esenciale e Barnave*” ka treguar që institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të përmbushin plotësisht synimet e parapara përmes Listës Esenciale të Barnave. Menaxhimi i Listës nuk është bërë në mënyrë efektive dhe efikase. Procesi i planifikimit, shpërndarjes dhe monitorimit të barnave si në nivelin dytësor ashtu edhe në atë tretësor është përcjellë me mangësi.

Si rezultat i gjetjeve në këtë raport të auditimit të performancës, ZKA kishte dhënë 12 rekomandime. Siç shihet edhe në Grafikon 4 më poshtë, rekomandimet janë dhënë për tri subjekte të audituara të cilat i takojnë nivelit qendror.

Grafiku 4 **Subjektet e audituara dhe numri i rekomandimeve të dhëna për fushën e shëndetësisë**



Nga rekomandimet e dhëna në raportin “*Lista Esenciale e Barnave*”,

- pesë rekomandime janë zbatuar plotësisht;
- një rekomandim është në fazën fillestare të zbatimit; dhe
- gjashtë rekomandime nuk janë më të aplikueshme (për më gjerësisht janë trajtuar tek subjekti përkatës)<sup>11</sup>.

<sup>11</sup> Rekomandimet e dhëna për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (më detajisht shih elaborimin për FSSH-në)

## Rekomandimet për Ministrinë e Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka ndërmarrë veprime për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport të auditimit të performancës. Nga katër rekomandimet e dhëna për këtë subjekt të audituar, tri rekomandime janë zbatuar plotësisht derisa për një rekomandim, MSh-ja ka filluar të marrë veprime drejt zbatimit të tij.

MSh-ja në dhjetor të vitit 2018 brenda afateve kohore të parapara kishte hartuar dhe dërguar planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve. Ky plan veprimi specifikon vitet kur pritet të zbatohen këto rekomandime, pra pa caktuar kohë specifike.

**Rekomandimi 1:** Që në afat sa më të shpejtë të bëjë azhurnimin e Listës Esenciale të Barnave.

Është zbatuar

MSh-ja tashmë ka përditësuar listën esenciale. Sipas planit të hartuar të veprimit, MSh-ja ishte zotuar se ky rekomandim do të zbatohet brenda vitit 2018/19. Revidimi i parë i kësaj liste, ishte bërë në vitin 2018 (shumë shpejt pas publikimit të raportit të auditimit të performancës). Ndryshimet e mëdha në disiplinat e ndryshme të mjekësisë, risitë nga periudha e pandemisë janë disa nga ngjarjet që kanë shkaktuar ndryshime rrënjësore në trajtimin e gjendjeve të ndryshme e që ka nxitur nevojën për një revidim të ri të listës. Puna rreth revidimit të radhës për listën esenciale kishte filluar në tetor të vitit 2022 për t'u përmbyllur në janar të vitit 2023.

**Rekomandimi 2:** Në bashkëpunim me profesionistët e ShSKUK-së të vazhdojë me hartimin e udhërrëfyesve klinik edhe për sëmundjet tjera dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Është zbatuar

Aktiviteti i profesionistëve shëndetësor për sa i përket udhërrëfyesve klinik sipas zyrtarëve të MSh-së është i vazhdueshëm. MSh-ja formon grupe punuese për hartimin e Udhërrëfyesve Klinik dhe Protokolleve Klinike qoftë për ShSKUK qoftë për Kujdesin Primar Shëndetësor (KPSH).

**Rekomandimi 3:** Komiteti teknik i formuar, në mënyrë të vazhdueshme përcjellë trendet botërore farmaceutike. Ndër të tjera komiteti, azhurnimet e ardhshme të LEB t'i bëjë në pajtim me udhërrëfyesit klinik dhe analizat kost-efektive.

Është zbatuar

Lista e produkteve mjekësore dhe materiali shpenzues është reviduar nga Komiteti Kyç duke marrë për bazë standardet e përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), nevojave të vendit dhe rëndësisë për shëndetin publik. Sipas zyrtarëve të MSh-së, Lista esenciale tani përmban rreth 70 produkte të reja të cilat shërbejnë për trajtimin e sëmundjeve të ndryshme.

**Rekomandimi 4:** Të funksionalizohet baza e të dhënave (Sistemi Informativ Shëndetësor) ku do të përfshiheshin të gjitha informatat rreth shpenzimeve të mbuluara për barna nga buxheti i shtetit dhe ato nga pacienti.

Ka filluar zbatimin

Lista Esenciale e Barnave është pjesë e Sistemit të Menaxhimit të Stokut Farmaceutik (SMSF). Menaxherët e Kontratave bëjnë përzgjedhjen e produkteve përkatëse për të cilat pastaj bëhet porosia, distribuimi dhe dalja për pacientin. MSh-ja është në proces të realizimit të projektit

“Track and Trace” përmes së cilës synohet të ofrohet një pasqyrë më e qartë të rrjedhës së barnave nga momenti i aplikimit për leje të importit në Republikën e Kosovës deri te shpërndarja dhe dalja te pacienti.

### Rekomandimet për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore

Gjashtë rekomandimet e dhëna për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore (FSSH) nuk janë të aplikueshme më për këtë subjekt të audituar. Kjo për arsye se çështjet që lidhen me rekomandimet adresuar kësaj të fundit kanë kaluar në menaxhim të ShSKUK-së.

|  |   |
|--|---|
| <b>Rekomandimi 5:</b> Të sigurojë përmes ShSKUK që planifikimi vjetor i barnave bëhet në mënyrë të njëjte nga të gjitha institucionet shëndetësore. Të hartohet procedurë standardizuese që përfshinë buxhetin në dispozicion, barnat sipas rëndësisë, stoqet dhe çështje tjera që ndërlidhen me një planifikim efektiv. | Nuk është më i aplikueshëm/Përgjegjësitë janë transferuar në ShSKUK |
| <b>Rekomandimi 6:</b> Të krijojë mekanizma për përcjelljen e skadimit të kontratave. Të fillohen procedurat e prokurimit në kohë të përshtatshme duke përfshinë periudhën e ankesave, anulimeve dhe ritenderimit.  | Nuk është më i aplikueshëm/Përgjegjësitë janë transferuar në ShSKUK |
| <b>Rekomandimi 7:</b> Të standardizojë periudhën e kërkesave nga institucionet shëndetësore për furnizim të çdo tremujori  | Nuk është më i aplikueshëm/Përgjegjësitë janë transferuar në ShSKUK |
| <b>Rekomandimi 8:</b> Të sigurohet që mënyra e raportimit të vonesave të jetë e obliguar për të gjitha institucionet shëndetësore dhe të përmbajë informatat e njëjta të bazuara në obligimet kontraktuale   | Nuk është më i aplikueshëm/Përgjegjësitë janë transferuar në ShSKUK |
| <b>Rekomandimi 9:</b> Në rastet e vonesave nga OE të merren masa në pajtim me obligimet kontraktuale.  | Nuk është më i aplikueshëm/Përgjegjësitë janë transferuar në ShSKUK |
| <b>Rekomandimi 10:</b> Të vendos sistemin e monitorimit, furnizimit dhe shpërndarjes së barnave. Po ashtu të përcjell zbatimin e kontratave nga OE dhe skadimin e këtyre kontratave  | Nuk është më i aplikueshëm/Përgjegjësitë janë transferuar në ShSKUK |

Menaxhimi i kontratave rreth furnizimit të Institucioneve Shëndetësore të Nivelit Dytësor dhe Tretësor me produkte nga Lista e Barnave Esenciale nga ana e FSSH ka përfunduar në fillim të vitit 2019. Që nga ajo periudhë e deri më tani (qershor 2023), menaxhimi dhe furnizimi me produkte nga Lista e Barnave Esenciale, ka kaluar dhe është në kompetencë të plotë të ShSKUK-së përmes vendimit të marrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MSh-së.

Çështjen lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve e kemi ri-adresuar në ShSKUK e cila për këtë çështje nuk ka kthyer përgjigje përkundër insistimit tonë.

### Rekomandimet për Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës

ShSKUK i ka zbatuar dy rekomandimet e dhëna në këtë raport të auditimit të performancës.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 11:</b> Të vendos një sistem të monitorimit në të gjitha institucionet shëndetësore, ku do të monitorohej gjendja e kërkesave, furnizimit, shpërndarjes, stokut dhe vonesave | Është zbatuar |
|---|---------------|

ShSKUK-ja ka marrë veprime në këtë drejtim pasi që ka funksionalizuar softuerin e integruar SMSF i cili mundëson monitorim të mirëfilltë të gjendjes së kërkesave, furnizimit, shpërndarjes, stokut në të gjitha repartet.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 12:</b> Të kërkohet nga të gjitha Ish-të të raportojnë në baza të rregullta rreth gjendjes së furnizimit, vonesave në shpërndarje dhe stoqeve. | Është zbatuar |
|---|---------------|


Me instalimin e SMSF-së secili Institucion Shëndetësor (Ish) monitorohet përmes sistemit i cili gjeneron raporte të rregullta mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore.

### 3.3.3 Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal

ZKA në auditimin e performancës “**Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal**” ka ekzaminuar performancën e menaxhimit të të hyrave vetanake në nivel komunal. Qëllimi i menaxhimit të të hyrave vetanake në komuna është që t’u ofrojë shërbime më të mira për qytetarin si kundërvlerë për pagesën e tyre. Konkluzioni i këtij raporti është që Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivelin lokal të qeverisjes nuk është duke u zhvilluar në nivel të kënaqshëm dhe sipas praktikave të mira.

Si rezultat i gjetjeve në këtë raport të auditimit të performancës, ZKA kishte dhënë 19 rekomandime. Edhe pse nëntë nga këto rekomandime janë dhënë për të gjitha komunat, ZKA ka dërguar pyetësorët për vlerësim të zbatimit të tyre vetëm për komunat që ishin në fushëveprim të auditimit (pra, pesë komuna). Përveç Komunës së Mitrovicës ne nuk kemi pranuar përgjigje lidhur me zbatimin apo jo të këtyre rekomandimeve. Komuna e Mitrovicës e kishte plotësuar pyetësorin mirëpo nuk e ka mbështetur atë me dokumente relevante për të vërtetuar nëse rekomandimet janë zbatuar. Në Grafikon 5 më poshtë janë paraqitur rekomandimet e dhëna për gjashtë subjektet e audituara, prej të cilave pesë i takojnë nivelit lokal (komunave) dhe një nivelit qendror (MFPT-së - Departamentit të Buxhetit).



Grafiku 5 **Subjektet e audituara dhe numri i rekomandimeve të dhëna në fushën e administratës publike**

Nga rekomandimet e dhëna në raportin “**Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal**”-

- Dy rekomandime janë zbatuar plotësisht;
- Një rekomandim është në fazën fillestare të zbatimit; dhe
- 16 rekomandime – nuk dihet niveli i zbatimit të tyre/nuk kemi përgjigje<sup>12</sup>.

### Rekomandimet për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

MFPT i është përgjigjur pozitivisht kërkesës për hartimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Shumë shpejt pas publikimit të raportit (nëntor, 2018), MFPT-ja kishte hartuar dhe dërguar planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna duke cekur edhe kohën për zbatimin e këtyre rekomandimeve e që ishte tremujori i parë i vitit 2019.

**Rekomandimi 1:** Të hartojë rregullore mbi procedurat që specifikojnë instruksione unike rreth procesit të planifikimit për të gjitha komunat, me qëllim të ofrimit të shpjegimeve të qarta për institucionet përgjegjëse në këtë proces. Më tej, ky udhëzues do të ofroj instruksionet specifike për palët e përfshira në proces, dhe në të njëjtën kohë, edhe përmbushjes së kërkesave metodologjike dhe procedurale.

Është zbatuar

Fillimisht, në plan të veprimit MFPT-ja ishte zotuar që do të hartojë dhe propozoj për aprovim rregulloren si akt nënligjor të projektligjit për financat e pushtetit lokal dhe se e njëjta ishte paraparë me plan të punës për vitin 2019. MF-ja nuk kishte hartuar ndonjë rregullore specifike por që Ministri i atëhershëm i Financave e kishte marrë një vendim në maj të vitit 2019 përmes së cilit kishte aprovuar procedurat për planifikimin e të hyrave vetanake komunale. Përmes këtij vendimi, Departamenti i Buxhetit kërkon nga komunat të përgatisin projeksionet e të hyrave vetanake për tri vite të ardhshme. Mes tjerash përmes këtij vendimi kërkohet që Komunat të bazohen në specifika të caktuara për të hyrat nga tatimi në pronë të paluajtshme,

<sup>12</sup> Komuna e Mitrovicës edhe pse ka dërguar pyetësorin nuk ka mbështet përgjigjet e saj me dëshmi, andaj nuk kemi mundur të vlerësojmë nivelin e zbatimit të atyre rekomandimeve

taksat e mbeturinave dhe të hyrat tjera vetjake komunale. Ky vendim është duke u zbatuar që nga dita e aprovimit dhe planifikimi i të hyrave vetanake vazhdon të bëhet në përputhje me këtë vendim.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 2:</b> Të rrisë nivelin e bashkëpunimit me komunat, përmes organizimit të takimeve të rregullta apo punëtorive të përbashkëta, në periudhat e para planifikimit të të hyrave me qëllim të shkëmbimit të praktikave të mira dhe mësimëve të nxjerra nga vitet e kaluara. | Është zbatuar |
|--|---------------|

MFPT-ja mban takime të rregullta për çdo proces buxhetor. Meqë vendimi parasheh që komunat të paraqesin parashikimet e tyre sa i përket të hyrave vetanake, atëherë MFPT-ja, më saktësisht Departamenti i Buxhetit Komunal mban takime ku diskutohen çështjet buxhetore me komunat përkatëse. MFPT ka bërë ftesa dhe ka mbajtur forume të ndryshme me qëllim të shkëmbimit të praktikave mes Komunave rreth zhvillimit të procesit buxhetor komunal, ku ndër palë tjera kishte edhe përfaqësues nga USAID dhe DEMOS.

### Rekomandimi për Komunën e Mitrovicës

|  |                   |
|--|-------------------|
| <b>Rekomandimi 3:</b> Të përgatisin raporte të rregullta vjetore të kryetarit, në veçanti për pasqyrimin e gjendjes së të hyrave, paraqitjen e rezultateve të arritura si dhe përfundimet dhe rekomandimet drejt realizimit të objektivave strategjike | Ka filluar zbatim |
|--|-------------------|

Edhe pse është përgjigjur në kërkesën tonë lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, duke specifikuar që ka filluar me zbatim, Komuna e Mitrovicës nuk ka ofruar dëshmi përkundër insistimeve tona që të elaboroj dhe mbështes me dëshmi hapat të cilat ka filluar t'i ndërmerr lidhur me këtë rekomandim. Andaj ne nuk kemi mundur të arrijmë në përfundim nëse Komuna e Mitrovicës ka filluar me zbatim apo jo të këtij rekomandimi.

### Rekomandime për komuna tjera

Komunat<sup>13</sup> për rekomandimet përkatëse (të paraqitura në shtojcën II) të cilat i'u janë adresuar atyre nuk janë përgjigjur kërkesës sonë të vazhdueshme për të ofruar informacione lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. Edhe pse këto rekomandime mund të ishin zbatuar deri më tani, për shkak të mos përgjigjes në pyetësorët e dërguar, ne nuk ishim në gjendje ta pasqyrojmë aktivitetin e këtyre subjekteve të audituara (komunave) lidhur me zbatimin apo jo të rekomandimeve të dhëna.

#### 3.3.4 Efektiviteti i programeve të veçanta për banim

Një ndër mesazhet e auditimit të performancës "*Efektiviteti i programeve të veçanta për banim*" ishte që Programi i Veçantë i Banimit nuk performon mirë pasi që shumica e atyre që kanë nevojë për banim social nuk kanë arritur të përfitojnë, dhe shumë pak është bërë për ta përmirësuar dukshëm këtë situatë.


Si rezultat i gjetjeve në këtë raport të auditimit të performancës, ZKA kishte dhënë 31 rekomandime. Edhe pse 12 nga këto rekomandime janë dhënë për të gjitha komunat, ZKA ka

<sup>13</sup> Komuna e Shtimes, Gjilanit, Lipjanit dhe Prishtinës

dërguar pyetësorët për vlerësim të zbatimit të tyre vetëm për komunat që ishin raste studimi në këtë auditim (pra, pesë komuna<sup>14</sup>), megjithatë ne nuk kemi pranuar përgjigje lidhur me zbatimin apo jo të këtyre rekomandimeve, gjë që e ka pamundësuar matjen e zbatimit të tyre.

Në Grafikon 6 më poshtë janë paraqitur rekomandimet e dhëna për subjektet e audituara, prej të cilave dy i takojnë nivelit qendror (Qeverisë së Kosovës dhe MMPHI) dhe pesë komuna.

**Grafiku 6 Subjektet e audituara dhe numri i rekomandimeve të dhëna në fushën sociale**



Nga rekomandimet e dhëna për raportin *“Efektiviteti i programeve të veçanta për banim”*

- Nëntë rekomandime janë zbatuar plotësisht;
- Tri rekomandime janë në fazën finale të zbatimit;
- Dy rekomandime janë në fazën fillestare të zbatimit;
- Dy rekomandime nuk kanë filluar të zbatohen;
- Tri rekomandime - nuk janë të aplikueshme për subjektin e audituar<sup>15</sup>; dhe
- 12 rekomandime - nuk dihet niveli i zbatimit të tyre/nuk kemi përgjigje

### Rekomandimet për Qeverinë e Kosovës

Për rekomandimet e adresuara për të, Qeveria e Kosovës nuk ka dërguar plan veprimi e rrjedhimisht nuk ka bërë ndonjë prioritizim për zbatimin e rekomandimeve.

Nga gjetjet e këtij raporti kanë dalë tri rekomandime për Qeverinë e Kosovës të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e procesit të banimit social. Sipas zyrtarëve të Qeverisë, bazuar në çështjet për të cilat janë dhënë rekomandimet, institucion përgjegjës është përcaktuar Qeveria e Kosovës, por mekanizma qeveritarë kryesor për adresimin e këtyre rekomandimeve dhe dhënies së përgjigjeve të kërkuara janë ministritë përkatëse. Prandaj, Qeveria ka deklaruar se këto rekomandime nuk janë të aplikueshme për të. Ne nuk kemi pranuar ndonjë konfirmim tjetër nëse këto rekomandime janë deleguar ministrive përkatëse.

<sup>14</sup> Komuna e Obiliqit, Gjakovës, Ferizajt, Mitrovicës dhe Prishtinës

<sup>15</sup> Rekomandimet e dhëna Qeverisë së Kosovës janë transferuar për t'u adresuar nga Ministritë përkatëse

|  |  |
|--|--|
| <b>Rekomandimi 1:</b> Të shqyrtojë nëse sistemi aktual për banim social është i përshtatshëm për ti përmbushur të gjitha kërkesat e banimit social në mënyrë efektive dhe vepron për të siguruar vendosjen e një sistemi funksional për banimin e qytetarëve në nevojë për banim social. | Nuk është më i aplikueshëm/Përgjegjësi e transferuar tek Ministria përkatëse |
|--|--|

|  |  |
|--|--|
| <b>Rekomandimi 2:</b> Bazuar në përvojën e mëhershme, përfshirë mangësitë e identifikuar në hartimin dhe zbatimin e një sistemi të duhur dhe që jep rezultate në banim social, për të parë nevojën për ndryshime të rregulloreve me qëllim që të mundësohet akomodimi i njerëzve në nevojë për banim social. | Nuk është më i aplikueshëm/<br>Përgjegjësi e transferuar tek Ministria përkatëse |
|--|--|

|  |  |
|--|--|
| <b>Rekomandimi 3:</b> Të qartësojnë zinxhirin e përgjegjësive për zhvillim dhe zbatim të PVB-ve. Më pas, të udhëzojnë institucionet përgjegjëse, me përkrahjen e organit të emëruar qeveritar që është përgjegjës për tërë programin, për të sqaruar zhvillimet dhe mënyrën e menaxhimit më të mirë. | Nuk është më i aplikueshëm/<br>Përgjegjësi e transferuar tek Ministria përkatëse |
|--|--|

### Rekomandimet për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka ndërmarrë veprime për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport të auditimit të performancës. Nga 15 rekomandimet e dhëna:-

- nëntë rekomandime janë zbatuar plotësisht,
- tre janë në fazën finale të zbatimit;
- për dy rekomandime ka filluar zbatimin; dhe
- për një rekomandim zbatimi nuk ka filluar ende.

MMPHI është një nga subjektet e pakta të audituara që ka dorëzuar plan veprimi për zbatim të rekomandimeve të auditimit për këtë raport. Ky plan veprimi i dërguar në dhjetor të vitit 2018 zbërthen në detaje hapat të cilat kjo Ministri do t'i ndërmerr për zbatim të rekomandimeve përfshirë akterët kyç dhe periudhën kohore se kur do të zbatohen ato. Divizioni i Banimit në kuadër të kësaj Ministrie ka bërë një punë të mirë drejt avancimit të çështjes së banimit social duke u mbështetur në gjetjet dhe rekomandimet e këtij auditimi të performancës.

|  |                             |
|--|-----------------------------|
| <b>Rekomandimi 4:</b> Të zhvillojë një program kombëtar banimi që adreson problemet e banimit me objektiva efektive, reale dhe strategjike të matshme, që janë të zbatueshme në punën e të gjitha institucioneve qendrore dhe lokale, përgjegjëse për PVB. | Në fazën finale të zbatimit |
|--|-----------------------------|

Për këtë rekomandim, janë marrë hapa konkrete drejt zbatimit të tij. Më saktësisht, Qeveria e Kosovës përmes Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZh 2023-2025), në aktivitetin që lidhet me banim, ka paraparë edhe një numër nën-aktivitetesh, siç janë:

- Hartimin dhe miratimin e Projektligjit për banim social;
- Hartimin dhe miratimin e UA-ve që rrjedhin nga Ligji për banim social;
- Ndërtimin e shtëpive në pjesën veriore të Kosovës;

- Hartimin dhe miratimin e Studim Fizibilitetit për banimin adekuat social në Republikën e Kosovës;
- Kërkesën për themelimin dhe funksionalizimin e njësisë implementuese të programit për banim social adekuat;
- Është themeluar ekipi punues për koordinimin dhe përgatitjen e procesit të “Programit të Banimit Adekuat Social për Kosovën”;
- Është themeluar Ekipi Negociator për Marrëveshjen e Kredisë me CEB;
- Është hartuar studimi i fizibilitetit për banim të përbalueshëm; dhe
- Ndërtimin e njësisë/objekteve të banimit social adekuat.

Me zbatimin e këtyre nën-aktiviteteve në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim të cekura më lartë, MMPHI pret të përmbyll zhvillimin e programit kombëtar të banimit me fokus adresimin e çështjeve të banimit.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 5:</b> Të marrë veprime për të siguruar krijimin e një plani real dhe të një sistemi funksional për banim social, që aplikohet në mënyrë të njëjtë në të gjitha rajonet dhe komunat, efektiv dhe efikas për akomodimin e të gjithë qytetarëve në nevojë për banim social. | Është zbatuar |
| <b>Rekomandimi 6:</b> Të ndihmojnë komunat në lidhje me shfrytëzimin e asetëve të tyre, e cila mund të ndihmoj në rritjen e fondit të tyre të banimit dhe t'i përdorin këto resurse në zgjidhjen e kërkesave për banim.  | Është zbatuar |
| <b>Rekomandimi 7:</b> Të sigurojë aplikim të kritereve të njëjta në të gjitha komunat, një sistem që mundëson që kërkesat më urgjente të trajtohen së pari dhe të ndihmojnë në plotësimin e të njëjtave edhe në komunat e tjera nëse ka fonde për banim.                                 | Është zbatuar |

Me funksionalizimin e platformës elektronike “**Aplikacioni për regjistrimin e kërkesave për banim social**” MMPHI, më saktësisht Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim (DPHNB) ka marrë veprime duke zbatuar tri rekomandimet e shpалosura më lartë.

Aplikacioni për regjistrimin e kërkesave për banim social është krijuar në kuadër të projektit “Banimi, një e drejtë themelore e njeriut” dhe është instaluar në Agjencinë për Shoqëri Informativë (AShI).

MMPHI ka organizuar trajnime mbështetur nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) për zyrtarët komunal (administratorët e caktuar nga Kryetarët e Komunave) për funksionalizimin e platformës elektronike të lartpërmendur.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve komunal për plotësimin e platformës elektronike për kërkesat e banimit social në nivel lokal. Kjo platformë elektronike ndihmon në monitorimin dhe raportimin e përfituesve të banimit social. Komunat kanë qasje të drejtpërdrejtë në aplikacion dhe mund të regjistrojnë të dhënat e kërkesave për banim social. Kriteret janë të njëjta për të gjitha komunat e tjera nëse ka fonde për Komunat sipas

ligjit në fuqi. Kriteret zbatohen nga niveli komunal sipas ligjit në fuqi derisa roli i Ministrisë në këtë rast (Zyrës Ligjore) është vetëm t'i shqyrtojë ankesat e palëve të pakënaqura.

Vlen të theksohet se deri më tani, vetëm 12 nga 38 komuna kanë filluar migrimin/regjistrimin e të dhënave në këtë platformë elektronike. Arsyet kryesore për numrin e ulët të regjistrimeve lidhen me mungesë të zyrtarit përkatës apo sektori për banim në kuadër të komunës<sup>16</sup>, kapacitetet e kufizuara dhe të dobëta brenda komunave, mangësitë teknike të lidhura me aplikacionin/bazën e të dhënave të projektuar si dhe është ofruar trajnim shumë bazë për përdoruesit e komunës se si të përdorin këtë aplikacion/bazë të të dhënave.

MMPHI ka ardhur në përfundim se duhet një vlerësim i detajuar i bazës së të dhënave/aplikacionit ekzistues. Ky projekt/aplikacion parashihet të avancohet përmes WBIF (2024-2026) të cilët e kanë për detyrë të hartojnë edhe Termat e Referencës, pas një analize të tyre.

**Rekomandimi 8:** Monitorojnë rregullisht performancën e komunave, si dhe të vëzhgojnë procesin dhe praktikën e aplikuar për të siguruar një proces efektiv të vlerësimit dhe përzgjedhjes, duke iu shmangur kriterëve të ashpra, dhe që vetëm aplikuesit e kualifikuar të përfitojnë nga programi i banimit.

Është zbatuar

Përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), janë shqyrtuar dokumentet e Komunave për programet tre vjeçare të banimit nëpër komuna dhe MMPHI posedon të gjitha të dhënat në formë tabelore për gjendjen për secilën Komunë në fushën e banimit.

**Rekomandimi 9:** Shqyrtojnë kufizimet e kualifikimit për vendbanim brenda komunës gjegjëse, marrë parasysh që komunat e vogla mund të kenë buxhet më të vogël për të përballuar problemin e banimit dhe në këtë drejtim familjet në nevojë për PVB të komunave të vogla mund të kenë shumë pak ose fare mundësi për të zgjidhur problemin e tyre të banimit.

Ka filluar zbatimin

Komunat e vogla kanë mundësitë e kufizuara për të zgjidhur problemin e tyre të banimit. Marrë këtë parasysh, MMPHI është fokusuar që komunat e vogla mos të merren me hartimin e programit tre vjeçar të banimit por të përkrahen në procesin e renovimit të shtëpive për familjet që i kanë kushtet e rënda të banimit. Një prej metodave të cilat disa Komuna aplikojnë në këtë fushë është bashkëpunimi me Organizata Jo Qeveritare (OJQ) për renovimin e shtëpive individuale. Edhe pse MMPHI nuk posedon raporte nga komuna për bashkëpunimin me OJQ-të, ajo është duke punuar të avancoj në këtë drejtim për t'a institucionalizuar këtë proces.

**Rekomandimi 10:** Krijojnë udhëzues dhe të vendosin një sistem gjithëpërfshirës, të integruar dhe koherent për monitorim, kontrollim, vlerësim dhe raportim të procesit.

Nuk ka filluar zbatimin

MMPHI-ja nuk ka filluar me zbatim të këtij rekomandimi. Një format i njëjtë për monitorim, kontrollim, vlerësim dhe raportim të procesit për të gjitha komunat nuk është krijuar. MMPHI

<sup>16</sup> Sipas ligjit për banim, i takon komunave të caktojnë një zyrtar apo sektor për banim

nuk ka ndërmarrë hapa për vendosjen e sistemit të integruar për shkak se fillimisht duhet përmbyllur proceset që kanë dalë si rezultat i studimit të fizibilitetit dhe të përfundohet rishikimi i udhëzimeve administrative që mbulojnë këtë fushë.

|  |                      |
|--|----------------------|
| <p><b>Rekomandimi 11:</b> Të sigurojnë vendosjen e një sistemi funksional për menaxhimin e informacionit, i cili do të ofrojë informata mbi nevojat për banim, fondin e banesave (banesa nga fondi i banimit që do të përdoren për banim social), numrin e familjeve të akomoduara, sipërfaqet e tokave që mund të përdoren për ndërtimin e objekteve banesore, dhe informacione të tjera relevante që do të ndihmojnë në planifikim dhe vendimmarrje në të ardhmen.</p> | <p>Është zbatuar</p> |
|--|----------------------|

Një prej veprimeve kryesore drejt zbatimit të këtij rekomandimi është ndërmarrë e që ka të bëjë me instalimin e aplikacionit të lartpërmendur për regjistrim të kërkesave për banim social. Edhe pse është funksionalizuar dhe është në përdorim nga një numër simbolik i komunave, aplikacioni ka nevojë të avancohet dhe kjo gjë do të bëhet përmes projektit që është WBIF (2024-2026), por që kjo bie në domenin e komunave.

|  |                                    |
|--|------------------------------------|
| <p><b>Rekomandimi 12:</b> Të vendosin një sistem bashkëpunimi i cili siguron shkëmbim koherent dhe gjithëpërfshirës të informatave me akterët tjerë relevant si Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në lidhje me shkëmbimin e informatave rreth nevojave për banim. Këto informata duhet të përfshijnë familjet të cilat, marrë parasysh situatën e tyre të rëndë socio-ekonomike, mendohet që nuk e kanë mundësinë e informimit nga mediat apo shpalljet në Komunë.</p> | <p>Në fazën finale të zbatimit</p> |
|--|------------------------------------|

Gjatë hartimit të udhëzimeve administrative të projektligjit për banim social dhe të përballeshëm ka bashkëpunim për vendosjen e kriterëve dhe mënyrës së poentimit të familjeve që do të aplikojnë. Përveç kësaj, sipas zyrtarëve të MMPHI-së bashkëpunimi do të realizohet edhe me ministritë tjera si: MAPL, MKK dhe MPB. Deri me tani projektet që realizohen në këto Ministri nuk janë në koordinim me projektet e MMPHI-së.

|  |                            |
|--|----------------------------|
| <p><b>Rekomandimi 13:</b> Siguroj që komunat kanë identifikuar dhe përfshirë banesat e ndërtuara nga Organizatat Ndërkombëtare Humanitare para vitit 1999 dhe banesat e ndërtuara nga institucionet shtetërore ose donatorët pas vitit 1999, që mund të rrisë numrin e banesave në dispozicion për Programet e Veçanta të Banimit dhe më pas të ofrojnë më shumë shtëpi për më shumë individë/familje në nevojë.</p> | <p>Ka filluar zbatimin</p> |
|--|----------------------------|

MMPHI në bashkëpunim me komuna është duke shikuar që përmes platformës elektronike t'i identifikojë dhe regjistrojë banesat e ndërtuara nga Organizatat Ndërkombëtare Humanitare para vitit 1999 dhe banesat e ndërtuara nga institucionet shtetërore ose donatorët pas vitit 1999, që mund të rrisë numrin e banesave në dispozicion për Programet e Veçanta të Banimit dhe më pas të ofrohen më shumë shtëpi për më shumë individë/familje në nevojë.

|  |                                    |
|--|------------------------------------|
| <p><b>Rekomandimi 14:</b> Monitoron pajtueshmërinë e të gjitha rregulloreve në nivel lokal me rregulloret bazë në lidhje me kriteret, kontratat e nënshkruara, kualifikimin e aplikantëve dhe rishikimin e rregulloreve në fuqi.</p> | <p>Në fazën finale të zbatimit</p> |
|--|------------------------------------|

Për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret, MMPHI përmes MAPL-së ka në fokus shqyrtimin e dokumenteve të prodhuara nga Komunitat për programet tre vjeçare të banimit në të cilat reflektohet gjendja e tyre për sa i përket banimit social. MMPHI është në pritje që Komunitat të përmbyllin procesin e caktimit të koordinatorëve për banim i cili parashihet me projektligjin për banim social dhe të përballueshëm. Me adresimin e kësaj çështjeje tek komunitat, MMPHI ka përmbyllur pjesën e vet të përgjegjësisë.

**Rekomandimi 15:** Të përcaktojë kriteret për rastet urgjente për të bërë identifikimin e prioriteteve urgjente për familjet/individët me probleme serioze shëndetësore dhe familjet/individët që jetojnë në ndërtesa të rrezikshme.

Është zbatuar

Çështjen e prioriteteve urgjente, MMPHI e kishte adresuar përmes platformës elektronike e cila parashih mundësinë që në momentin e regjistrimit të kërkesave të gjenerojë listën prioritare të familjes që kanë nevojë urgjente.

**Rekomandimi 16:** Të vendos një sistem të rregullt të rishikimit të rregulloreve për përcaktimin e radhës së prioritetit, veçanërisht kriteret financiare në lidhje me harmonizimin e kufijve financiar në përputhje me normën e inflacionit.

Është zbatuar

Harmonizimi i kufijve financiar si dhe përcaktimi i radhës së prioritetit lidhen me aprovimin të projektligjit për banim social dhe të përballueshëm<sup>17</sup>. Pas aprovimit të këtij ligji do rishikohen edhe udhëzimet administrative përkatëse që rregullojnë këto dy fusha. Pasi që ky rekomandim është adresuar tek MMPHI, ajo ka ndërmarrë të gjitha veprimet që i takojnë asaj, pritet vetëm formalizimi e që ky proces nuk është në dorën e Ministrisë. Andaj, ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

**Rekomandimi 17:** Të përcaktojë qartë kriteret e sistemit të vlerësimit me pikë për familjet që kujdesen për më shumë se një anëtar të familjes me probleme shëndetësore; për familjet me numër të ndryshëm të anëtarëve të familjes, dhe familjet me më shumë se një jetim nën kujdesje; për anëtarët e familjes së aplikantëve për banim bazuar në moshë, dhe të shmangin dykuptimësinë mbi vlerësimin e moshës së familjarëve 18 vjeçar.

Është zbatuar

Sipas zyrtarëve përgjegjës, kriteret janë të përcaktuara me udhëzimin administrativ nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit.

Me projektligjin e hartuar e që është në fazën e fundit të miratimit, MMPHI ka ndryshuar disa nga kriteret të cilat merren si bazë për vlerësimin me pikë të individit, familjes apo bashkësisë familjare, në bazë të së cilave bëhet rangimi i tyre derisa kriteret specifike më pas do të rregullohen me akt nënligjor pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pasi që ky rekomandim është adresuar tek MMPHI, sikurse në rekomandimin më lartë, ajo ka ndërmarrë të gjitha veprimet që takojnë asaj, pritet vetëm formalizimi e që ky proces nuk është në dorën e Ministrisë.

<sup>17</sup> Ky projektligj është në fazën finale të aprovimit



|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 18:</b> Të rishqyrtojë kriteret për kohëzgjatjen e vendbanimit brenda zonës së komunës përkatëse duke marrë parasysh vështirësitë për akomodimin e banorëve në nevojë për banim social në komunat më të vogla, të cilat kanë buxhet më të vogël. | Është zbatuar |
|---|---------------|

Me studimin e fizibilitetit të banimit social, Programi është paraparë të mbështes këto shtylla:

- Ndërtimin e Njësive të reja për Banim social;
- Renovimin e Njësive dhe Ndërtesave të Banimit Social;
- Rindërtimin dhe renovimin e Shtëpive individuale; dhe
- Subvencionimin e familjeve me të ardhura të ulëta që përfitojnë nga programet e banimit adekuat social.

Duke u mbështetur në këto objektiva, MMPHI siguron që vendbanimi të jetë brenda zonës së komunës përkatëse dhe të akomodojë banorët në nevojë për banim social në komunat më të vogla, të cilat kanë buxhet më të vogël. Për më tepër, përmes këtij studimi të fizibilitetit dhe rezultatet që kanë dalë janë kriteret janë rishqyrtuar kriteret dhe me këtë është zbatuar rekomandimi.

### Rekomandimi për Komunën e Mitrovicës

|  |                       |
|--|-----------------------|
| <b>Rekomandimi 19:</b> Komuna e Mitrovicës në lidhje me kontratën për ndërtimin e shtëpive sociale të veprojë në bazë të kontratës së nënshkruar, që të sigurohet ndërtimi i këtyre shtëpive nga kontraktuesi sipas kushteve të kontratës. | Nuk ka filluar zbatim |
|--|-----------------------|

Komuna e Mitrovicës nuk ka ndërmarrë veprime për të adresuar rekomandimin në fjalë. Gjendja e konstatuar nga ekipi i auditimit i cili ka kryer këtë auditim vazhdon të ekzistojë. Sikurse ekipi i kaluar i auditimit, as ne nuk kemi mundur të sigurojmë dëshmi për të vërtetuar ndërtimin e shtëpive me vlerë prej 161,000€. Dokumentacioni i ofruar ishte i kufizuar (vetëm kontratat e qirasë së tokës së komunës për vitin 2010 dhe një njoftim me shkrim dërguar kontraktorit në vitin 2013 për të kujtuar detyrimet e tij kontraktuese që duhej të ishin plotësuar deri në vitin 2012. Sikurse atëherë edhe tani, autoritetet komunale gjatë intervistave të auditimit kanë pretenduar se kushti i kontratës është përmbushur, megjithatë nuk ishin në gjendje të ofronin dëshmi për të vërtetuar se kontraktori ka ndërtuar shtëpitë sipas marrëveshjes.


### 3.3.5 Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit

Një ndër mesazhet e auditimit të performancës "*Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit*" është se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk i ka vendosur të gjitha parakushtet e nevojshme ligjore për rregullimin e gjendjes së cilësisë së ajrit në Kosovë si dhe nuk e ka azhurnuar të gjithë kornizën e nevojshme ligjore sipas gjendjes aktuale të cilësisë së ajrit në

vend. Korniza e vendosur nuk shërben si udhërrëfyes që lehtëson punën e institucioneve për të ndërmarrë masa konkrete në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit.

Si rezultat i gjetjeve në këtë raport të auditimit të performancës, ZKA kishte dhënë 13 rekomandime. Edhe pse tri nga këto rekomandime janë dhënë për të gjitha komunat, ZKA ka dërguar pyetësorët për vlerësim të zbatimit të tyre vetëm për komunat që ishin në fushëveprim të auditimit (pra, pesë komuna), megjithatë ne nuk kemi pranuar përgjigje lidhur me zbatimin apo jo të këtyre rekomandimeve, gjë që e ka pamundësuar matjen e zbatimit të tyre. Në Grafikon 7 më poshtë janë paraqitur 10 rekomandimet e dhëna për MMPHI së bashku me dy agjencitë e saj Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), të gjitha të nivelit qendror. Përveç këtyre janë edhe tri rekomandime adresuar komunave.

Grafiku 7 **Subjektet e audituara dhe numri i rekomandimeve të dhëna në fushën e mjedisit**



Nga rekomandimet e dhëna për raportin *Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit*,

- Nëntë rekomandime janë zbatuar plotësisht;
- Një rekomandim - nuk ka filluar zbatim; dhe
- Tri rekomandime – nuk dihet niveli i zbatimit të tyre/nuk kemi përgjigje.

**Rekomandimet për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës)**

Subjektet e audituara të përfshira në këtë auditim nuk kanë hartuar plan veprimi për zbatim të rekomandimeve. Edhe pse ky institucion nuk ka ndjekur ndonjë proces prioritizimi të zbatimit të rekomandimeve, zbatim i ishte në nivel prej 90% në nivel të subjektit të audituar. Veprime të theksuara për ndryshimin e gjendjes brenda subjektit për sa i përket cilësisë së ajrit ka ndërmarrë Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 1:</b> Përfundojë sa më parë vlerësimin e ndikimit financiar të Ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe të bëjë miratimin e versionit të ri të këtij ligji; | Është zbatuar |
|--|---------------|

Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pasi që Ligji nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja ka hyrë në fuqi më 13 korrik të vitit 2022 në datën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Procedura e miratimit të një ligji kërkon që para aprovimit të tij të ketë të plotësuar formularin për vlerësimin e ndikimit financiar, më pas analizohet në MF e me pajtim nga kjo e fundit procedohet për miratim së pari në Qeveri pastaj në Kuvend.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 2:</b> Komplettojë legjislacionin sekondar, duke i dhënë përparësi miratimit të versionit të rishikuar të UA për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes. | Është zbatuar |
|--|---------------|

Legjislacioni sekondar, më saktësisht Udhëzimi Administrativ nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes ka hyrë në fuqi më 29 korrik 2021. Me këtë është kompletuar legjislacioni sekondar.

|   |                         |
|---|-------------------------|
| <b>Rekomandimi 3:</b> Funkcionalizojë brenda një kohë të shkurtër Strategjinë për cilësi të ajrit përmes miratimit të PVCA 2018-2020. | Nuk ka filluar zbatimin |
|---|-------------------------|

Funksionalizimi i Strategjisë për cilësinë e ajrit nuk ka filluar ende pasi që MMPHI është në pritje të miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm nga Kuvendi i Kosovës. Pas këtij veprimi, pritet të zhvillohen aktivitetet për hartimin e Planit për Cilësinë e Ajrit.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 4:</b> Përpilojë raporte të zbatimit të masave të parapara në planet emergjente 2016/2017 dhe 2017/2018. | Është zbatuar |
|---|---------------|

MMPHI, konkretisht Departamenti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Ujërave (DMMU) bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 03/1-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (i shfuqizuar) ka përpiluar raportet me masat për tejkalimin e pragut të alarmit dhe cilësinë e dobët të ajrit për të normalizuar gjendjen të cilat masa janë ndërmarrë në koordinim me MMPHI, Qeverinë dhe autoritetet lokale-komunat.

Edhe pse me këtë ligj nuk është kërkuar të përpilohet një raport konkret i zbatimit të planit emergjent, MMPHI gjatë raportimeve për masat e zbatuara për cilësinë e ajrit (PKZh), ka përfshirë masat të cilat janë parapara në planet emergjente të cilësisë së ajrit.

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja i publikuar në korrik të viti 2022, ky Departament obligohet pas çdo plani të cilësisë së ajrit të përgatis raportin e zbatimit ashtu siç është vepruar me përpilimin e raportit të zbatimit të Strategjisë për Cilësinë e Ajrit. Duke u mbështetur në këtë, DMMU ka raportuar lidhur me këto masa në bazë të cilave kishte nxjerrë edhe vendime<sup>18</sup> në favor të mbrojtjes së cilësisë së ajrit.

<sup>18</sup> Vendimi për ndalimin e dhënies në shfrytëzim të thëngjillit punëtorëve të KEK

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 5:</b> Monitorojë dhe inspektorë në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e operatorëve ekonomik të cilët konsiderohen si ndotës të mëdhenj të ajrit. Të mos bazohet vetëm në raportet që gjenerohen nga ta, mirëpo të realizojë vizita të shpeshta inspektuese për të verifikuar raportimet e tyre lidhur me ndotjen e ajrit që shkaktohet nga veprimtaria e tyre | Është zbatuar |
|--|---------------|

Sipas inspektoratit të MMPHI-së, në vitet e fundit e sidomos pas rekomandimeve të dhëna nga ZKA, të gjithë ndotësit industrial (të cilët konsiderohen si ndotësit më të mëdhenj) dhe ato subjekte të cilat janë të pajisura me Leje Mjedisore të Integruar<sup>19</sup> por edhe ato të cilat janë në procedurë apo edhe i'u janë refuzuar këto leje, janë përfshirë në planin e punës për inspektime të rregullta. Përveç inspektimeve të rregullta, Inspektorati ka kryer edhe inspektime me kërkesë dhe në bazë të ankesave.

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 6:</b> Funkcionalizohet në tërësi rrjeti monitorues i cilësisë së ajrit përmes servisimit të të gjitha stacioneve, dislokimit të atyre stacioneve që ende nuk janë dislokuar në lokacione adekuate, mirëmbajtjes së vazhdueshme të tyre përgjatë tërë vitit si dhe përmirësimit të sigurisë së stacioneve për të evituar dëmet e mundshme | Është zbatuar |
|--|---------------|

MMPHI përmes Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, më saktësisht Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës ( IHMK) ka krijuar rrjetin shtetëror të monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë.

IHMK kishte marrë mbështetje nga Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës – MFK (financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit-MCC) për zhvillimin e mëtejshëm të rrjetit të komunikimit që ofron të dhëna për cilësinë e ajrit në kohë reale nëpërmjet këtij portali online. Në muajin nëntor të vitit 2019, IHMK është mbështetur nga MFK për zhvendosjen e tri Stacioneve për Monitorimin e Cilësisë së Ajrit (SMCA) në Gjiilan, Prizren dhe Drenas, si dhe renovimin e rrethojës metalike në Mitrovicë.

Nga muaji nëntor i vitit 2019, pajisjet e reja të cilësisë së ajrit janë instaluar në 7 SMCA, ndërsa trembëdhjetë njësi të Furnizimit të Pandërprerë me Energji Elektrike (UPS), trembëdhjetë sensorë meteorologjikë dhe regjistruer të të dhënave, ruterë dhe kamera të sigurisë me SIM kartela të instaluar për të mundësuar transmetimin pa tela të të dhënave u instaluan në 12 SMCA dhe një SMCA mobil. Në IHMK është instaluar edhe një kompjuter me performancë të lartë, i cili monitoron të dhënat dhe imazhet nga të gjitha stacionet.

Pas instalimit të pajisjeve, stafi i IHMK-së është trajnuar për Procedurat Standarde të Operimit për analizërë (CO, NOx, O3, PM, SO2) dhe atë në përdorimin, mirëmbajtjen, kalibrimin dhe operimin e pajisjeve të instaluar rishtazi.

Edhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian e ka mbështetur IHMK-në duke investuar në rrjetin e komunikimit të SMCA për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në 8 nga 12

<sup>19</sup> Me këtë leje pajisen subjektet që konsiderohen ndotësit më të mëdhenj dhe me rrezik për mjedisin

SMCA, me të dhënat e lidhura në një aplikacion në telefon të mençur (Android dhe iOS) për t'i lejuar publikut qasje në të dhënat e cilësisë së ajrit për Kosovë.

Pas këtij investimi, një kompani vendase është kontraktuar nga JICA dhe MMPHI për të mirëmbajtur dhe servisuar 12 SMCA, nga të cilat 5 mbështetur nga JICA dhe shtatë nga MMPHI.

**Rekomandimi 7:** Krijojë një sistem të centralizuar të mbledhjes dhe përpunimit automatik të të dhënave që gjenerohen nga stacionet monitoruese, si dhe një sistem që është në gjendje të gjenerojë në mënyrë automatike raporte përmbledhëse për secilin prej stacioneve monitoruese

Është zbatuar

Me krijimin e rrjetit shtetëror të monitorimit të cilësisë së ajrit në Kosovë, MMPHI (AMK dhe IHMK) kanë arritur të krijojnë një sistem të centralizuar të mbledhjes dhe përpunimit automatik të të dhënave që gjenerohen nga stacionet monitoruese. Ky sistem është në gjendje të gjenerojë në mënyrë automatike raporte përmbledhëse për secilin prej stacioneve monitoruese.

**Rekomandimi 8:** Sigurojë matje dhe raportim në kohë reale të cilësisë së ajrit për secilin prej stacioneve monitoruese si dhe për të gjithë parametrat që përmbajnë këto stacione

Është zbatuar

Rrjeti shtetëror i monitorimit të cilësisë së ajrit tani është plotësisht në funksion në Kosovë, si dhe mundëson matje dhe raportim në kohë reale të cilësisë së ajrit për secilin prej stacioneve monitoruese si dhe për të gjithë parametrat që përmbajnë këto stacione.

**Rekomandimi 9:** Monitorojë në mënyrë të vazhdueshme në veçanti tejkalmimet e vlerave kufitare të parametrave që e ndotin ajrit (sidomos grimcave PM10 dhe PM2.5), dhe të merren masa adekuate dhe të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes

Është zbatuar

Rrjeti shtetëror i vënë në funksion mundëson që monitorimi të kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në veçanti tejkalmimet e vlerave kufitare të parametrave që e ndotin ajrin (sidomos grimcave PM10 dhe PM2.5).

**Rekomandimi 10:** Intensifikojnë bashkëpunimin me nivelin lokal në aspekt të monitorimit, raportimit dhe informimit të tyre për gjendjen e cilësisë së ajrit që gjenerohet nga rrjeti i centralizuar i monitorimit të cilësisë së ajrit

Është zbatuar

Në bashkëpunim me Projektin e JICA-s<sup>20</sup> dhe me komunat përkatëset, IHMK ka vendosur gjashtë "Display" në Prishtinë, një në Obiliq dhe një në Pejë në të cilat shfaqen të dhënat nga Monitorimi i Cilësisë së Ajrit. Këto të dhëna shfaqen çdo 1 orë dhe informojnë qytetarët lidhur me indeksin e Cilësisë së Ajrit.

Tri rekomandimet adresuar komunave mund t'i gjeni në shtojcën II të këtij raporti.

<sup>20</sup> Japan International Cooperation Agency/ Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar


### 3.3.6 Vlera për para në prokurimet e centralizuara, Pjesa e parë

Konstatimi i auditimit të performancës “Vlera për para në prokurimet e centralizuara, Pjesa e parë” që Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) kishte synuar që përmes procedurave të centralizuara të kryej prokurime efikase dhe më ekonomike (me kosto më të ulët) që do të rezultnin me kursime buxhetore, janë disa çështje të rëndësishme operative që paraqesin pengesë në përmbushjen e këtyre objektivave. Këto çështje kanë të bëjnë me mangësi të rëndësishme gjatë zbatimit të procedurave të centralizuara.

ZKA-ja ka kryer edhe një auditim të pjesës së dytë për të vlerësuar nëse është arritur vlera për para në aktivitetet e centralizuara të prokurimit, gjegjësisht a janë arritur kursime buxhetore, si dhe a ka nxjerrë mësim AQP-në nga përvoja në prokurimet e para të centralizuara.

Si rezultat i gjetjeve në këtë raport të auditimit të performancës (pjesën e parë), ZKA kishte dhënë tetë rekomandime (një për MFPT-në dhe shtatë për AQP-në). Tri rekomandime janë zbatuar, një është në fazën finale të zbatimit, për dy rekomandime ka filluar zbatimin ndërsa për dy tjera nuk ka filluar ende zbatimin. Në grafikun 8 më poshtë janë paraqitur rekomandimet sipas subjektit të audituar përfshirë numrin e rekomandimeve.

**Grafiku 8 Subjektet e audituara dhe numri i rekomandimeve të dhëna në fushën e prokurimit**



## Rekomandimi për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

Edhe pse nuk është dërguar plan veprimi për zbatim të rekomandimit, MF-ja në bashkëpunim me Agjencinë Qendrore të Prokurimit ka ndërmarrë masa për zbatim të rekomandimit të dhënë.

**Rekomandimi 1:** Për të siguruar që prokurimet e centralizuara janë efektive dhe sigurojnë vlerën për para, Ministria e Financave duhet ta mbështesë Agjencinë Qendrore të Prokurimit duke e rishikuar udhëzimin administrativ për prokurimet e centralizuara, ku do të sigurojë se Autoritetet Kontraktuese veprojnë në pajtim me obligimet e tyre sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me Agjencinë Qendrore e Prokurimit.

Ka filluar zbatim

Sipas zyrtarëve përgjegjës, MFPT së bashku me AQP kanë krijuar një grup të veçantë për hartimin e Listës së artikujve të përbashkët, e cila Listë në formë Udhëzimi është përcjellë përmes Ministrit në Qeveri. Kjo listë është miratuar nga Qeveria më 26 prill 2023 e që mbulon vitin 2023. Edhe pse sipas zyrtarëve përgjegjës ky rekomandim është cilësuar si i zbatuar, Udhëzimi i hartuar përmban listën e artikujve të përbashkët dhe informata tjera më të përgjithshme, por që nuk përmban kërkesa për veprime shtesë të cilat do të siguronin se Autoritetet Kontraktuese veprojnë në pajtim me obligimet e tyre sa i përket komunikimit dhe bashkëpunimit me Agjencinë Qendrore e Prokurimit. Prandaj ky rekomandim nuk mund të cilësohet si plotësisht i zbatuar.

## Rekomandimet për Agjencinë Qendrore të Prokurimit

Përkundër që për këtë raport auditimi AQP-ja nuk kishte hartuar plan veprimi, e njëjta ka ndërmarrë disa veprime drejt zbatimit të pesë nga shtatë rekomandimeve të dhëna në këtë raport.

**Rekomandimi 2:** Të zhvillojë hulumtimin e tregut, në veçanti të analizojë kontratat e individuale të Autoriteteve Kontraktuese të cilat do të përfshihen në kontratë të centralizuara për të identifikuar se çfarë çmimesh janë të kontraktuara aktualisht dhe duke pasur parasysh rritjen e sasisë sa do të mund të kishte reduktime të mëtejme të çmimit për secilën kontratë.

Është zbatuar

Që nga viti 2015 për artikujt që janë në listë aktivitetet udhëhiqen vetëm nga AQP-ja dhe me këtë rast, analizimi i kontratave paraprake të AQP-së mbetet opsion i vetëm.

AQP-ja për një procedurë të caktuar lidhur me karburante<sup>21</sup> kishte analizuar kontratat e rajonit të Gjilanit për karburante të cilat i kanë udhëhequr të gjitha komunat e asaj pjese (Gjilan, Kamenicë, Viti, Kllokot, Partesh), ku ka analizuar vlerat e atyre kontratave, gjatë së cilës analizë zyrtarët e AQP-së kishin konstatuar se vlerat e atyre kontratave ishin 25% deri në 50% më të larta se vlera e kontratës së AQP-së për këtë rajon e nënshkruar në dhjetor 2022. Megjithatë, duke e pasur parasysh që sasi të që prokurohen nga AK individuale nuk janë as të përafërta me sasi të që prokurohen me procedura të centralizuara të prokurimit, edhe pritjet janë që çmimet të jenë shumë më të ulëta tek këto të fundit.

<sup>21</sup> Për arsye të caktuara këto institucione kishin udhëhequr procedurat e prokurimit në mënyrë vetanake

|  |               |
|--|---------------|
| <b>Rekomandimi 3:</b> Ta llogarisë vlerën e parashikuar të kontratës bazuar në çmimet e arritshme të cilat do të merreshin si pikë referuese dhe kundrejt të cilave do të vendosej se a janë të pranueshme çmimet e ofertave. Në rast se çmimi i ofertës e tejkalon atë të parashikuar prokurimi duhet anuluar pavarësisht deklaramëve të AK-ve. | Është zbatuar |
|--|---------------|

AQP për vlerë të parashikuar tashmë (edhe pas rekomandimeve të auditimit “Prokurimet e Centralizuara, pjesa e dytë) merr për bazë një kombinim në mes të çmimeve të tregut dhe çmimeve të kontratave paraprake. Për disa produkte – produktet ushqimore të gjithë artikujt për të cilat ofron ASK-ja të dhëna janë vendosur vlerat e parashikuara sipas atyre të dhënave (buka, qumështi etj.), ndërsa në rastet e tjera si tek karburantet kombinimi ishte me çmimet e tregut. AQP-ja kishte anuluar aktivitetin e prokurimit “**Shërbimet e transportit ajror**” pasi që çmimi i ofertës kishte tejkaluar vlerën e parashikuar.

|   |                             |
|---|-----------------------------|
| <b>Rekomandimi 4:</b> Të kërkojë nga Autoritetet Kontraktuese deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve për t’u siguruar që kërkesat e tyre të shprehura janë reale dhe sigurojnë që kontratat do të shfrytëzohen mjaftueshëm duke kufizuar mundësitë për mbi shfrytëzim apo nën shfrytëzim të të gjitha kontratave. | Në fazën finale të zbatimit |
|---|-----------------------------|

Sipas, AQP-së, ata kanë filluar të aplikoj kërkesën për deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve për furnizime që kanë kosto më të madhe, (aktiviteti i prokurimit “Furnizim me Vetura apo marrja e veturave me qira”), ku së bashku me kërkesën për vetura është kërkuar të dorëzohet edhe deklarata e disponueshmërisë së mjeteve. Këtë deklaratë, AQP-ja e kishte kërkuar dhe për aktivitete tjera p.sh “**furnizim me karburant**” vetëm për autoritetet që shpenzojnë më së shumti në kontratat e centralizuara (Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës). Duke e pasur parasysh që deklarata e disponueshmërisë së mjeteve nuk kërkohet për të gjitha AK-të dhe për të gjitha procedurat e centralizuara, ky rekomandim nuk mund të quhet i zbatuar plotësisht.

|  |                       |
|--|-----------------------|
| <b>Rekomandimi 5:</b> Nevojat e konstatuara të secilit Autoritetet Kontraktues të dokumentohen si shtojcë e kontratës e cila do të shërbente si masë për të parandaluar devijimet e mundshme pra për t’u siguruar që realizimi është në përputhje me kontraktimin si për nga sasia ashtu edhe për nga vlera. | Nuk ka filluar zbatim |
|--|-----------------------|

Në kontratë vendosen të gjitha Autoritetet Kontraktuese ndërsa kërkesat e tyre analizohen nga AQP bazuar në raportet e kontratave, pra për secilën kontratë kërkohen raportet për sasinë e realizuar nga secili Autoritet Kontraktues (AK) që shfrytëzon atë kontratë. Sipas zyrtarëve të AQP-së te kontratat e reja sasia e paraparë e tyre çdo herë tashmë harmonizohet me raportet e kontratave të kaluara dhe realizimi i tyre është shumë i mirë dhe pothuaj që çdo herë realizimi është rreth 100% të kontratës. Edhe pse AQP ka deklaruar se rekomandimi është zbatuar, duke e pasur parasysh që sasi të e kërkuara nga AK-të individuale nuk bëhen pjesë e kontratave si shtojcë, ky rekomandim nuk mund të quhet i zbatuar.



|  |                     |
|--|---------------------|
| <b>Rekomandimi 6:</b> Të bëjë një monitorim të implementimit të kontratës duke siguruar që Autoritetet Kontraktuese i respektojnë se obligimet dhe të drejtat në secilën kontratë të centralizuar dhe në rast të devijimeve të mundshme nga plani, të ndërmarr masa korrigjuese, në mënyrë që të parandalojë rreziqet e mundshme për ndonjë humbje financiare. | Ka filluar zbatimin |
|--|---------------------|

AQP bën monitorimin e implementimit të kontratave, ku mes tjerash kërkohet nga kontraktuesit që në raport të përfshijnë edhe vonesat në pagesa nga AK-të. Sipas zyrtarëve të AQP-së, kjo e fundit nuk ka ndonjë ndikim në këtë pikë përveç vendosjes në kontratë që kontraktuesi me një paralajmërim 30 ditë më parë mund ta largoj një AK nga kontrata në rast se ka vonesë në pagesë më shumë se 90 ditë. Sipas AQP-së ky rekomandim është zbatuar.

Ndërmarrja e disa veprimeve, tregon që AQP ka filluar të shqyrtoj zbatimin e rekomandimit, megjithatë mbështetja vetëm në raportet e OE-së tregon që masat e ndërmarra nuk janë të mjaftueshme.

|   |               |
|---|---------------|
| <b>Rekomandimi 7:</b> Lista e artikujve për përdorim të përbashkët të azhurnohet në pajtim me nevojat reale të Autoriteteve Kontraktuese. Për të siguruar efikasitet operativ, në listën e artikujve për përdorim të përbashkët të përfshijë vetëm artikuj për të cilët kanë nevojë shumica e Autoriteteve Kontraktuese | Është zbatuar |
|---|---------------|

Lista e artikujve për përdorim të përbashkët është azhurnuar. Nga lista e artikujve për përdorim të përbashkët janë larguar dy artikuj (dru dhe pelet) për të cilët kishin nevojë vetëm dy Autoritete Kontraktuese. Në listën e artikujve për përdorim të përbashkët kemi hasur artikullin “Furnizim me Mazut” për të cilin kanë shprehur nevojë tri AK-të (spitale). Arsyeja e parë pse AQP ka zhvilluar procedurë të prokurimit për këto tre institucione ishte zhvillimi i një procesi më efikas dhe të reduktohet burokracia. Në vend që të ndahen dhe të realizohen prokurimet për secilin institucion në mënyrë të veçantë, ata po punojnë së bashku për të ndarë kostot dhe të optimizojnë procesin e furnizimit me mazut. Arsyeja e dytë lidhet me faktin se AQP është përgjegjëse për pagesën e berzës për marrjen e çmimeve për derivate të naftës. Për të realizuar këtë, është zgjedhur të fillohet me vetëm tri institucione për t'u siguruar që procesi funksionon dhe për të vlerësuar rezultatet para se ky aktivitet të zgjerohet më shumë.

|  |                         |
|--|-------------------------|
| <b>Rekomandimi 8:</b> Se çdo prokurim i centralizuar që zhvillohet të jetë e bazuar në një procedurë operative e cila aktualisht mungon e që do të duhej të hartohet sa më parë që të jetë e mundur. | Nuk ka filluar zbatimin |
|--|-------------------------|

AQP-ja për zhvillimin e procedurës së prokurimit lëndën e shpërndan me rotacion. Zyrtari përgjegjës i lëndës e ka për obligim t'i caktojë çelësat për hapje të tenderit, me rotacion dy zyrtar kryesor dhe dy zyrtar ndihmës. Brenda pesë ditëve, zyrtari përgjegjës i prokurimit i propozon Zyrtarit Kryesor Administrativ anëtarët e komisionit, i cili i miraton apo kërkon ndryshime.

Kur tenderët nuk janë me vlera të mëdha dhe me specifikime të thjeshta siç janë furnizimet, vlerësimi kryhet edhe nga zyrtarët e AQP-së. Ndërsa për tenderët me shuma më të mëdha dhe specifikime më të komplikuar anëtar të komisionit caktohen edhe nga autoritetet kontraktuese tjera të cilat kanë pjesëmarrje më të madhe në kontratë të centralizuar.


Në këtë drejtim, AQP-ja cakton për anëtar të komisionit për hartimin e specifikimeve teknike edhe nga autoritetet tjera. Sipas AQP-së, ky rekomandim cilësohet si i zbatuar. Megjithatë, rekomandimi ka të bëjë me hartimin e një procedure operative e cila do të përcaktonte saktë rrjedhën e një procedure të centralizuar dhe personat përgjegjës për procese të caktuara. Edhe pse në praktikë janë zbatuar disa hapa, mos hartimi i një procedure të shkruar/dokumenti nuk siguron që këta hapa do të zbatohen në çdo procedurë të centralizuar.

### 3.3.7 Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura

Një nga konkluzionet e auditimit të performancës *“Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura”* ishte që Qeveria e Kosovës nuk ka arritur të instalojë mekanizma të qëndrueshëm të cilët do të ndihmonin në koordinimin, monitorimin dhe raportimin e bashkëfinancimeve.

Si rezultat i gjetjeve në këtë raport të auditimit të performancës, ZKA kishte dhënë 14 rekomandime. Përkundër insistimeve dhe komunikimit me zyrtarë përgjegjës në subjektet e audituara, përgjigje për nivelin e zbatimit të rekomandimeve kemi marrë vetëm për tri sosh (Komuna e Prizrenit, Prishtinës dhe Ministria e Shëndetësisë) derisa për 11 rekomandime<sup>22</sup> tjera nuk kemi marrë përgjigje.

Grafiku 9 Subjektet e audituara dhe numri i rekomandimeve të dhëna në fushën e administratës publike



<sup>22</sup> një adresuar Qeverisë së Kosovës, pesë adresuar ish MIE - tani pjesë e ZKM-së, katër rekomandime për dy Ndërmarrje publike dhe një për Komunën e Fushë Kosovës

## Rekomandimi për Komunën e Prizrenit

**Rekomandimi 1:** Komuna e Prizrenit si implementues për projektet të sigurojë se janë duke u realizuar projektet krahas të gjitha objektivave të përcaktuara të programeve zhvillimore të donatorit dhe ti promovojë ato në mënyrë që të arrihen rezultate.

Është zbatuar

Pas ndërtimit të stadiumit në shtëpinë malore (Bjeshkatare)<sup>23</sup>, kjo hapësirë është funksionalizuar edhe më tej (aty janë mbajtur vite me radhë takime ndërkombëtare të bjeshkatave me organizim nga Shoqata -ShB "SHARRI" nga Prizreni. Gjatë kësaj periudhe (prej implementimit të projektit e deri me tani) ajo pjesë (përfshirë stadiumin) është shfrytëzuar edhe nga Shkollat Fillore për aktivitetet e tyre shkollore të Komunës së Prizrenit. Përveç Prizrenit, edhe Regjioni i Dragashit dhe Opojës shfrytëzojnë atë pjesë për të realizuar aktivitete të ndryshme rekreative. Kjo "shtëpi malore" shërben si vendqëndrim edhe nga studentë ndërkombëtarë si nga Sllovenia, dhe Universiteti i Prishtinës - dega e biologjisë.

## Rekomandimi për Ministrinë e Shëndetësisë

MSh-ja ka dërguar plan veprimi për zbatim të këtij rekomandimi ku ka theksuar veprimet që do të ndërmerren për sa i përket realizimit të tij.

**Rekomandimi 2:** Ministri i shëndetësisë në të ardhmen duhet të sigurojë bashkëpunim në nivel të duhur me zyrtarët e ZKA-së, si dhe të rishikoj proceset e arkivimit, ruajtjes dhe sistemimit të dokumenteve dhe t'i identifikoj arsyet e mos ofrimit të informatave të plota për auditimin, njëkohësisht të përforcoj mekanizmat e kontrollit dhe llogaridhënies me qëllim që këto situata të mos përsëriten në të ardhmen. Si dhe të sigurojë se objektivat e përcaktuara në marrëveshje për realizimin e projektit do të kryhen me kohë

Është zbatuar

MSh ka ndërmarrë veprime konkrete në këtë drejtim dhe bashkëpunimi me zyrtarët e ZKA-së nuk mungon dhe veprohet menjëherë duke caktuar zyrtarin përgjegjës kontaktues, zyre për vendosjen e ekipit të auditimit. Bashkëpunimi sipas kërkesave të ekipit të auditimit të ZKA-së përmes personit kontaktues pa përjashtuar takimet individuale është në nivel.

## Rekomandimi për Komunën e Prishtinës

**Rekomandimi 3:** Komuna e Prishtinës si pronare e projektit dhe si bashkëfinancues të sigurojë se me rastin e bashkëfinancimeve në të ardhmen të koordinoj aktivitetet e tyre me komunat e tjera qëllim të realizimit të projektit në tërësi. Po ashtu në të ardhmen gjatë implementimit të projekteve të caktojë menaxherin e projektit në mënyrë që të rrisë transparencën mbi procesin e realizimit, mbikëqyrjes dhe monitorimin e projekteve

Ka filluar zbatimin

Komuna e Prishtinës në të gjitha projektet me bashkëfinancim të cilat i ka nënshkruar ka filluar t'i zbatoj. Për secilin projekt ka marrëveshje të nënshkruar nga Kryetari dhe pala tjetër

<sup>23</sup> Ky projekt ka qenë mostër e auditimit

financuese. Po ashtu për secilin projekt ka rritur mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të projekteve duke caktuar menaxher të projektit.

### **Rekomandimet për të cilat nuk kemi pranuar përgjigje**

Për nëntë rekomandime (Shih Shtojcën II) nuk kemi pranuar përgjigje lidhur me nivelin e zbatimit të tyre. Përkundër insistimeve tona, ne nuk kemi mundur të sigurojmë informacione se deri ku kanë arritur subjektet e audituara me zbatim të rekomandimeve për raportin *“Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura”*.

## 4. Konkluzionet

Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar zbatimin e 123 rekomandimeve të dhëna në shtatë raporte të auditimit të performancës për 46 subjekte të audituara.

Zbatimi i rekomandimeve për shtatë raportet e auditimit të performancës ishte në nivel prej 37%, i cili nuk paraqet një nivel jo edhe aq të kënaqshëm. Kjo nënkupton që shumica e rekomandimeve ose janë në faza të ndryshme të zbatimit ose nuk janë zbatuar fare. Ky është një tregues se ende ka hapësirë për përmirësim në zbatimin të rekomandimeve të dhëna nga ZKA. Përqindja e zbatimit të rekomandimeve në tri prej shtatë auditimeve individuale të performancës është shumë më e mirë. Ajo sillet nga 42% deri në 69% të rekomandimeve të zbatuara.

Auditimi i performancës “**Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit**”, ka pasur ndikim në përmirësimin e proceseve që lidhen me politikat e punësimit. Zbatimi i 15 rekomandimeve ka bërë që APRK-ja si bartëse e këtyre proceseve të avancojë tutje lidhur me efikasitetin dhe efektivitetin e politikave qeveritare të punësimit. Sidoqoftë, janë edhe gjashtë rekomandime, që ndodhen në faza të ndryshme të zbatimit, edhe pse kanë kaluar rreth pesë vite që nga publikimi i raportit. Pesë rekomandime tjera nuk janë të aplikueshme gjë që mund të ndikoj në rezultatin përfundimtar të synuar përmes rekomandimeve të dhëna në këtë raport.

Auditimi i performancës “**Lista Esenciale e Barnave**” përmes rekomandimeve të dhëna ka ndikuar që menaxhimi i Listës të avancojë më tutje dhe të bëhet sadopak në mënyrë më efektive dhe më efikase. Me zbatimin e rekomandimeve, MSh dhe ShSKUK kanë përmirësuar procesin e planifikimit, shpërndarjes dhe monitorimit të barnave si në nivelin dytësor ashtu edhe në atë tretësor duke adresuar disa nga mangësitë me të cilat është përcjellë ky proces. Ri-organizimi i FSSh-së dhe transferimi i përgjegjësive tek ShSKUK dhe mos përgjigja e kësaj të fundit në pyetësor për veprimet e marra, na ka pamundësuar të kemi informacione lidhur me progresin e menaxhimit të kontratave rreth furnizimit me produkte nga Lista e Barnave Esenciale.

Auditimi i performancës “**Efektiviteti i programeve të veçanta për banim**” kishte rezultuar me një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve. Përmes rekomandimeve, auditimi kishte ndikuar që MMPHI përmes Departamentit për Banim të përmirësojë dukshëm këtë situatë duke trajtuar pengesat që Programi i Veçantë i Banimit të performoj më mirë krahasuar me gjendjen e identifikuar përmes auditimit. Edhe pse përmes rekomandimeve është arritur të përmirësohet dukshëm gjendja, moszbatimi i rekomandimit lidhur me udhëzuesin për monitorim dhe sistemin koherent ka ndikuar që mos të realizohen plotësisht synimet e parapara me këtë auditim. Mungesa e përgjigjeve për 12 rekomandime si dhe tri transferuara na kanë pamundësuar të përcaktojmë saktësisht rezultatet nga ky auditim.

**Komuna e Mitrovicës nuk ka ndërmarrë hapa** për të adresuar rekomandimin e auditimit. Gjendja e konstatuar nga ekipi i auditimit, që dëshmon mungesën e dokumentacionit për të vërtetuar ndërtimin e shtëpive, vazhdon të ekzistojë. Pavarësisht pretendimeve të autoriteteve komunale se kontrata është përmbushur, ata nuk kanë ofruar dëshmi për të konfirmuar

ndërtimin e shtëpive sipas marrëveshjes. Mungesa e dëshmive për zbatim të rekomandimit nuk ofron siguri se shtëpitë janë ndërtuar dhe që është marrë kundërvlerë për mjetet e paguara.

Auditimi i performancës **“Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit”** ka pasur ndikim duke bërë që Instituti Hidrometeorologjik si pjesë e AMMK-së (në kuadër të MMPHI) përmes zbatimit të rekomandimeve të dhëna në nivel zbatimi prej 90% të funksionalizojë rrjetin shtetëror për monitorim të cilësisë së ajrit në Kosovë. IHMK ka arritur rezultate të prekshme për sa i përket monitorimit dhe raportimit të cilësisë së ajrit. Edhe pse ka rezultate të dukshme, mos funksionalizmi i strategjisë për cilësi të ajrit edhe pas pesë vitesh tregon se MMPHI duhet të vazhdojë punën në fushën e mjedisit për të përfunduar me sukses proceset lidhur me cilësinë e ajrit. Mungesa e përgjigjeve nga komunat për tre rekomandime nuk na ofron një pamje të qartë lidhur me ndikimin dhe rezultatet që ky auditim kishte tek subjektet e audituara (komunat).

Agjencia Qendrore e Prokurimit ka treguar progres në përmirësimin e proceseve operative pas publikimit të raportit **“Vlera për para në prokurimet e centralizuara, Pjesa e parë”**. Vendimi për të kërkuar deklaratën e disponueshmërisë së mjeteve, fillimi i hulumtimit të tregut dhe largimi i procedurave të vogla (me pak AK), ka ndikuar që këto procedura të bëhen më efikase dhe efektive. Në këtë proces ka ndikuar edhe auditimi i pjesës së dytë të prokurimeve të centralizuara. Edhe pse ka shënuar progres, AQP-ja edhe pas rreth pesë vitesh dhe dy auditimeve të performancës të kryera në këtë subjekt, ajo ende duhet të ndërmarrë veprime për të arritur rezultate më të larta të synuara nga auditimi.

Mos përgjigjja ndaj kërkesave të ZKA-së mbi veprimet që subjektet e audituara kanë ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve për dy raporte të auditimit (**Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal dhe Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura**) ka shpërfaqur mungesë të llogaridhënies dhe përgjegjësisë për të raportuar për progresin e tyre dhe për të adresuar çështjet e identifikuara nga ZKA. Mos përgjigjja ndaj kërkesave të ZKA-së dhe mos raportimi mbi veprimet e mundshme të ndërmarra rreth zbatimit të rekomandimeve, tregon në njëfarë mënyrë edhe mos gatishmëri të subjekteve të audituara për të qenë më ekonomike, efikase dhe efektive gjatë arritjes së objektivave të përcaktuara.

Mos përgatitja e planeve të veprimit dhe mos prioritizimi i zbatimit të rekomandimeve tregojnë se subjektet e audituara duhet të angazhohen më shumë për të plotësuar fillimisht kërkesat ligjore e pastaj edhe për të përmirësuar llogaridhënien dhe transparencën në aktivitetet e tyre. Megjithatë, këtu duhet cekur se disa subjekte përkundër që nuk kishin dorëzuar plan të veprimit ato kishin ndërmarrë veprime dhe kishin shënuar progres drejtë përmirësimit të gjendjen në institucionin e tyre.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë qartë domosdoshmërinë për një përkushtim më të lartë dhe një bashkëpunim më të zgjeruar ndërmjet subjekteve të audituara dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit. Kjo është thelbësore për të nxitur përmirësimin e performancës së institucioneve dhe për të siguruar llogaridhënie dhe përgjegjësi të plotë në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

# Shtojca I. Motivi i auditimit, kriteret, pyetjet, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

## Motivi i Auditimit

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga raportet individuale të auditimit të performancës bëhet përmes auditimeve të veçanta, të cilat njihen edhe si “faza e përcjelljes”. Pas këtij procesi nxjerrën edhe rezultatet e zbatimit të rekomandimeve.

Përmes auditimeve të performancës, ZKA-ja i ka ofruar Kuvendit dhe subjekteve të audituara rekomandime të dobishme që të përmirësojnë dhe rrisin ekonomikitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në sektorë të rëndësishëm si: shëndetësi, mjedis, sistemet e teknologjisë informative, prokurimi publik. Rekomandimet e auditimit të performancës kanë përfshirë si nivelin e qeverisjes qendrore ashtu edhe atë lokale. Mirëpo, niveli i zbatimit të rekomandimeve mbetet i ulët. Ndër arsytet për zbatimin e ultë të rekomandimeve janë edhe mungesa e proceseve formale për monitorimin e mirëfilltë dhe sistematik të planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, si dhe mungesa e përkushtimit të duhur për trajtimin e tyre, janë ndër shkaktarët kryesorë për nivelin e ulët të zbatimit të rekomandimeve. Po ashtu, mungesa e mbikëqyrjes efikase nga ana e Qeverisë dhe organeve mbikëqyrëse, ka ndikuar që organizatat buxhetore të shmangin zbatimin e plotë të tyre.

## Pyetjet e auditimit

Për t’iu përgjigjur objektives së auditimit, kemi formuluar pyetjet dhe nën-pyetjet në vijim:

### **1. A janë dërguar planet e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe a janë zbatuar rekomandimet nga subjektet e audituara?**

1.1 A janë dërguar/hartuar me kohë dhe si duhet planet e veprimit nga subjektet e audituara?

1.2 A janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të auditimit sipas prioritetit të përcaktuar në plan të veprimit?

### **2. A kanë arritur rekomandimet rezultatin e synuar të përmirësimit të gjendjes në subjektin e audituar?**

2.1 A kanë zbatuar subjektet e audituara ndryshimet në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit?

2.1 Cila është gjendja në subjekte të audituara pas publikimit të raportit të auditimit?

### Kriteret e auditimit:

Kriteret për përcjellje të zbatimit të rekomandimeve janë bazuar në parimet kryesore të përcaktuara me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit<sup>24</sup>.

Gjendja faktike krahasuar me gjendjen e pas zbatimit të rekomandimeve ishte përdorur për të vlerësuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të performancës për vitin 2018.

Për të verifikuar këtë, kemi aplikuar kriteret e përmbledhura:

- Pas publikimit të raportit të auditimit subjektet e audituara duhet të hartojnë planet e veprimit (aktiviteteve) për zbatim të rekomandimeve të dhëna dhe të sigurohen se ato zbatohen sipas afateve kohore të specifikuara në plan<sup>25</sup>;
- Në një periudhe të arsyeshme kohore pas publikimit të raportit të auditimit të performancës, subjekti i audituar duhet të siguroj progres në përputhje me zotimet në plan të veprimit<sup>26</sup>;
- Subjekti i audituar duhet të vë në funksion një mekanizëm formal për të adresuar secilin rekomandim. Përmes këtij mekanizmi duhet të sigurohet gjurmimi i secilit rekomandim derisa adresimi të përfundojë apo të arrihet zgjidhja e problemit<sup>27</sup>; dhe
- Subjekti i audituar nuk kufizohet vetëm me zbatim të rekomandimeve, por mund të fokusohet në trajtimin e problemeve në mënyrë adekuate dhe zgjidhje të problemeve pas periudhe të arsyeshme<sup>28</sup>.

### Metodologjia e Auditimit

Qasja jonë për këtë auditim përcjellës ka përfshirë një varg teknikash për të marrë dëshmi dhe siguri për këtë auditim përcjellës, ndër to: intervistimi i zyrtarëve përkatës (sipas nevojës), analizimi i dokumenteve relevante dhe testimet e nevojshme. Më konkretisht jemi fokusuar në:

- Analizimin e planeve të dorëzuara të veprimit;
- Analizimin e përgjigjeve të pranuar nga pyetësi i dërguar përmes së cilit palët përgjegjëse na informojnë me shkrim lidhur me aktivitetet që janë ndërmarrë për të adresuar problemet e prezantuara në raportin e auditimit;
- Analizimin e dokumenteve/dëshmimeve të pranuar që dëshmojnë aktivitetet e ndërmarra nga ana e subjektit për zbatim të rekomandimeve të dhëna;
- Komunikimin me subjektet e përfshira në auditime, telefonata dhe email konfirmues lidhur me gjendjen faktike në subjekt; dhe
- Vizita për të mbledhur informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga subjekti i audituar.

<sup>24</sup> SNISA 3000 dhe 5200

<sup>25</sup> Udhëzuesi për përcjellje të zbatimit të rekomandimeve, ZKA

<sup>26</sup> SNISA 3200, faqe 34/35,

<sup>27</sup> <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/10.1002/9781119529132.ch14>

<sup>28</sup> SNISA 3000 - standardi 146



Fushëveprimi dhe kufizimet e këtij auditimi

Ky auditim përcjellës për bazë kishte raportet e auditimit të performancës të publikuara në vitin 2018. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur institucionet e përfshira në auditim, të ndara sipas raporteve të auditimit të publikuara brenda këtij vitit 2018.

**Tabela 2 Raportet e auditimit dhe subjektet e përfshira në auditim**

| Raportet e auditimit  | Subjektet e përfshira në auditim  |
|---|---|
| 1 Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit                               | Zyra e Kryeministrit,<br>Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale<br>Agjencinë për punësim,<br>Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br>Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë   |
| 2 Lista Esenciale e Barnave   | Ministria e Shëndetësisë<br>Fondi i Sigurimeve Shëndetësore<br>Qendra Klinike Universitare të Kosovës<br>Spitale të përgjithshme (3)  |
| 3 Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal   | Ministria e Financave (Departamenti i Buxhetit Komunal)<br>Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal (Departamenti për Monitorim të Komunave)<br>Komuna e Prishtinës<br>Komuna e Gjilanit,<br>Komuna e Mitrovicës,<br>Komuna e Lipjanit<br>Komuna e Shtimes.   |
| 4 Efektiviteti i programeve të veçanta për banim  | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor<br>Komuna e Obiliqit,<br>Komuna e Gjakovës,<br>Komuna e Ferizajt,<br>Komuna e Mitrovicës<br>Komuna e Prishtinës   |
| 5 Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës)<br>(Instituti Hidrometeorologjik të Kosovës)  |
| 6 Vlera për para në prokurimet e centralizuara - Pjesa e parë                                     | Ministria e Financave (Agjencia Qendrore e Prokurimit)  |
| 7 Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura            | Ministria e Integriteteve Evropiane<br>Ministria e Financave<br>Ministria e Zhvillimit Ekonomik<br>Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë<br>Ministria e Shëndetësisë<br>NP "Hidromorava"<br>NP "Hidro regjioni jugor",<br>Komuna e Prizrenit,<br>Komuna e Gjakovës,<br>Komuna e Fushë Kosovës<br>Komuna e Prishtinës. |

Tabela 3 Raportet e auditimit dhe numri i subjekteve sipas niveleve

| Nr | Auditimet e Performancës  | Subjektet | NQ        | NL        | NP       |
|----|---|-----------|-----------|-----------|----------|
| 1  | Efikasiteti dhe efektiviteti i politikave qeveritare të punësimit                               | 5         | 5         |           |          |
| 2  | Lista Esenciale e Barnave   | 6         | 6         |           |          |
| 3  | Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal   | 7         | 2         | 5         |          |
| 4  | Efektiviteti i programeve të veçanta për banim  | 7         | 2         | 5         |          |
| 5  | Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit | 7         | 2         | 5         |          |
| 6  | Vlera për para në prokurimet e centralizuara – Pjesa e parë                                     | 2         | 2         |           |          |
| 7  | Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura            | 12        | 6         | 4         | 2        |
|    |   | <b>46</b> | <b>25</b> | <b>19</b> | <b>2</b> |

Në raportet e auditimit të performancës për vitin 2018 janë përfshirë 46 subjekte të audituara. Nga këto subjekte, 25 subjekte janë të nivelit qendror (Ministri dhe Agjenci vartëse) dhe 19 prej tyre i takojnë nivelit lokal (komuna) përderisa në fushëveprim ishin përfshirë edhe 2 ndërmarrje publike.


#### Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant

Përgjegjësia për përcjelljen e rekomandimeve të auditimit dhe raportimin mbi rezultatet e zbatimit duhet të jetë e udhëheqësit të ekipit të auditimit apo e një zyrtari tjetër të ZKA-së të caktuar nga Drejtori i departamentit të auditimit dhe në koordinim me Auditorin e Përgjithshëm.

Përcjellja e rekomandimeve të auditimit dhe raportimi lidhur me rezultatet e zbatimit të rekomandimeve përcaktohet me procedurë për sigurimin dhe përcjelljen e rekomandimeve të auditimit të performancës të miratuara nga Auditori i Përgjithshëm.

Personi i caktuar për përcjellje të rekomandimeve dhe raportim të rezultateve të zbatimit, mundë të caktohet gjithashtu për të monitoruar ose për tu koordinuar nga afër me personin i cili monitoron ekzekutimin e rezolutave dhe vendimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe komisioneve të tij sipas materialit të auditimi.

Diagrami 1 Procesi i auditimit përcjellës



## Shtojca II. Tabela me rekomandimet për të cilat nuk kemi marrë përgjigje

| Raporti i auditimit                             | Rekomandimi  | Entiteti përgjegjës  | Statusi i rekomandimit |
|---|--|--|------------------------|
| Menaxhimi i të hyrave vetanake në nivel komunal | Të hartojë Planin strategjik zhvillimor Komunal, ku në këtë proces do të duhej të përfshihen të gjitha palët e interesit, të përmbajë koston financiare dhe të ketë indikatorët matës si dhe më pas të bëj monitorimin e tyre me qëllim të përmbushjes së objektivave të planifikuara.   | Komuna e Lipjanit  | Nuk ka përgjigje       |
|   | Të hartojë Planin strategjik zhvillimor Komunal, ku në këtë proces do të duhej të përfshihen të gjitha palët e interesit, të përmbajë koston financiare dhe të ketë indikatorët matës si dhe më pas të bëj monitorimin e tyre me qëllim të përmbushjes së objektivave të planifikuara.   | Komuna e Gjilanit  | Nuk ka përgjigje       |
|   | Të bëj ridizajnimin e strategjisë duke bërë përditësimin me informata të rëndësishme dhe specifike, duke paraparë edhe implikimin buxhetor për zbatimin e strategjisë si dhe duke përcaktuar afatet kohore për arritjen e objektivave strategjike në planin operativ të cilën e posedon.   | Komuna e Prishtinës  | Nuk ka përgjigje       |
|   | Përveç Planeve Strategjike Zhvillimore, duhet të sigurohen se kanë edhe planet e tyre të veprimit/operative, e të cilat duhet të përmbajnë objektivat specifike, aktivitetet që do të realizohen, indikatorë të matshëm, përgjegjësit, afatin kohorë, si dhe buxhetin/analiza e koston mbi realizimin e këtyre objektivave. Më tej, komunat duhet të sigurohen se posedojnë sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të strategjive të tyre.                              | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime) | Nuk ka përgjigje       |
|   | Të prodhojnë raporte të rregullta vjetore dhe periodike karshi planeve të veta operative për të rishikuar progresin rreth përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave strategjike. Raportet e tilla do të sigurojë komunave që zhvillimi i aktiviteteve është në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore, si dhe objektivave strategjike.   | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime) | Nuk ka përgjigje       |
|   | Të hartojnë një Deklaratë të politikave mbi të hyrat, duke përfshirë edhe parimet që qeverisja lokale synon të aplikojë në vitin financiar mbi përcaktimin e tarifave, ngarkesave dhe çmimeve për të mbuluar kostot e plota ekonomike si dhe të sigurojë që ka sistem për ngritjen e kapaciteteve për grumbullimin e këtyre të hyrave si dhe destinimin e shpenzimit të tyre.  | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime) | Nuk ka përgjigje       |
|   | Të krijojë procedura të brendshme formale për planifikimin e të hyrave vetanake, që specifikon instruksione të qarta për pjesëmarrësit e përfshirë në këtë proces me qëllim të ofrimit të dhënave rreth asaj se çfarë analiza dhe parametra duhet marrë parasysh me rastin e planifikimit nga njësitë që gjenerojnë të hyra. Më tej, krijimi i këtyre procedurave do të jenë bazë për një sistem të rregulluar dhe të mirëfilltë të planifikimit të të hyrave vetanake | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime) | Nuk ka përgjigje       |
|   | Të sigurojnë se realizimit të të hyrave vetanake duhet t'i paraprijë një proces i mirëfilltë i planifikimit, përmes identifikimit të barrierave (pengesave) dhe ndërmarrjen e masave për realizimin e objektivave të komunës bazuar në analizën e gjendjes për gjatë viteve paraprake dhe potencialeve ekzistuese  | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime) | Nuk ka përgjigje       |



|                                     |   |   |                  |
|-------------------------------------|---|---|------------------|
|                                     | Shpërndarja dhe shpenzimi i të hyrave bëhet bazuar në dokumentet strategjike të tyre, përfshirë deklaratën e politikave mbi destinimin e shfrytëzimit të të hyrave vetanake, duke marrë parasysh investimet e planifikuara dhe kriteret e përcaktuara               | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime)    | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Të ushtrojnë kontrollë mbi shpenzimin e të hyrave drejt realizimit të projekteve të tyre në mënyrë që të sigurohen se këto të hyrat janë duke u shpenzuar në mënyrë efikase dhe efektive me qëllim të përdorimit të tyre dhe minimizimit të bartjes në vitin vijues | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime)    | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Ti identifikojnë format dhe mekanizmat të cilat sigurojnë vendosjen e komunikimit dhe organizimit të takimeve të rregullta me qytetarët, me qëllim të identifikimit të nevojave dhe prioritetëve të tyre  | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime)    | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Të hartojnë plan të veprimit mbi implementimin e rekomandimeve të dhëna nga MAPL me qëllim të planifikimit dhe shpenzimit të të hyrave vetanake për projektet e identifikuar në këto raporte  | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime)    | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Të pregatisin raporte të rregullta vjetore të kryetarit, në veçanti për pasqyrimin e gjendjes së të hyrave, paraqitjen e rezultateve të arritura si dhe përfundimet dhe rekomandimet drejt realizimit të objektivave strategjike                                    | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime)    | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Të dizajnojnë dhe zhvillojnë metoda të avancuara të raportimit duke i përmbushur kriteret e plotësisë, saktësisë dhe koherencës për pasqyrimin e gjendjes dhe paraqitjen e rezultateve të arritura në raport me objektivat e parapara;                              | Komuna e Gjilanit   | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Të dizajnojnë dhe zhvillojnë metoda të avancuara të raportimit duke i përmbushur kriteret e plotësisë, saktësisë dhe koherencës për pasqyrimin e gjendjes dhe paraqitjen e rezultateve të arritura në raport me objektivat e parapara;                              | Komuna e Lipjanit   | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Të dizajnojnë dhe zhvillojnë metoda të avancuara të raportimit duke i përmbushur kriteret e plotësisë, saktësisë dhe koherencës për pasqyrimin e gjendjes dhe paraqitjen e rezultateve të arritura në raport me objektivat e parapara;                              | Komuna e Shtimës  | Nuk ka përgjigje |
|                                     | Të veprojnë për të siguruar përpilimin e planeve reale dhe të një sistemi funksional për banim social, efikas dhe efektiv për akomodimin e të gjithë qytetarëve në nevojë për banim social brenda komunës së tyre.  | Komunat (Mitrovica, Prishtina, Gjilani, Lipjan dhe Shtime)    | Nuk ka përgjigje |
| <i>Efektiviteti i programeve të</i> | Të rishikojnë programet aktuale të banimit dhe të eliminojnë parregullsitë ekzistuese, përfshirë dhënien me qira të banesave ekzistuese të destinuara për banim social të kategorive tjera sociale.   | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |

|  |   |                  |
|--|---|------------------|
| Të sigurojnë vendosjen e një procesi koherent të identifikimit të nevojave për banim social pa marrë parasysh se a ka ndonjë aplikacion për PVB, ose mos trajtimi i rasteve kur gjendja e tyre shumë serioze shëndetësore ose socio-ekonomike mendohet se pamundëson informimin e tyre mbi proceset në komunë  | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të sigurohen që nevojat më urgjente identifikohen dhe të trajtohen në radhë të parë dhe në mënyrë koherente, duke nënkuptuar se prioriteti i jipet nevojave më urgjente.   | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të sigurohet aplikimi i kriterëve të barabarta për të gjithë aplikantët në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve, duke shmangur kriteret e ashpra dhe që vetëm aplikuesit e kualifikuar të përfitojnë nga programi i banimit.  | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të sigurojë vendosjen e një procesi të rregullt dhe gjithëpërfshirës të kontrollit të përfituesve aktualë të PVB, që do të ndihmojnë komunat në identifikimin e përfituesve që kanë të ardhura më të larta, dhe ata që kanë përmirësuar situatën e tyre socio-ekonomike, dhe banesat që përdoren prej tyre mund të ri-jepen qytetarëve të tjerë në nevojë  | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të sigurojë vendosjen e një sistemi për regjistrim dhe arkivim të dosjeve të përfituesve dhe dosjeve të refuzuara, që do të mundësojë monitorim më të lehtë të përfituesve.  | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të sigurojë që të gjithë përfituesit të jenë të pajisur me kontratën e qiradhënies, ku përcaktohen të gjitha dispozitat përfshirë kohëzgjatjen e kontratave të qirasë bazuar në analizën e bërë mbi probabilitetin kohor për ndryshime në statusin socio-ekonomik të përfituesve.  | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të vendosë një rrjedhë efikase të procesit mbi vlerësimin e aplikacioneve dhe përzgjedhjen e përfituesve që anashkalojnë burokracinë dhe siguron vendim-marrje të shpejtë dhe të duhur.  | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të aplikojnë mekanizma inspektimi përmes të cilave do të dokumentohen rezultatet dhe do të shërbejnë si bazë për planifikimin dhe vendimmarrje në të ardhmen. Ky mekanizëm duhet të jetë i lidhur drejtpërdrejt me monitorimin, raportimin dhe kontrollimin e procesit të zbatimit të përgjithshëm të PVB nga Qeverisja qendrore, në mënyrë që të mundësojë zbatimin e përgjithshëm dhe të aplikojë sanksione kur është e nevojshme; | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Që banesat aktualisht të marra me qira nga përfituesit të cilët mund të përballojnë çmimet e tregut, të boshatisen dhe të jepen në përdorim të kërkesave më urgjente   | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina) | Nuk ka përgjigje |
| Të sigurohet pajtueshmëri e plotë e të gjitha rregulloreve të nivelit lokal me rregulloren bazë në lidhje me kriteret, kontratat e nënshkruara dhe kualifikimin e aplikantëve.   | Komunat (Obiliqi, Gjakova,                                    | Nuk ka përgjigje |

|   |  |  |                  |
|---|--|--|------------------|
|   |  | Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina)                               |                  |
| Mekanizmat institucional për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit | Miratojnë PLVM-të sa më parë që është e mundur (në këtë rast komuna e Prishtinës), si dhe për pjesën tjetër të komunave të cilave u ka kaluar vlefshmëria kohore e PLVM-ve, ti ripërtërijnë ato sa më parë për një periudhë tjetër pesë vjeçare.   | Komunat (Obiliqi, Gjakova, Ferizaji, Mitrovica dhe Prishtina)    | Nuk ka përgjigje |
|   | Përpilojnë raportet e zbatimit të masave të parapara në PLVM, sidomos ato masa që kanë për qëllimin adresimin e ndotjes së ajrit. Raportet të përfshijnë numrin dhe llojin e masave të realizuara, shkallën e realizimit të tyre, kostot e përfshira për realizimin e tyre, si dhe efektin që pritet të arrijnë ato në përmirësim të cilësisë së ajrit.  | Komunat (Prishtina, Mitrovica, Obiliq, Hani i Elezit dhe Gjilan) | Nuk ka përgjigje |
|   | Raportojnë në baza tre mujore, jo vetëm për zbatimin e masave të parapara në PLVM, mirëpo për çdo aktivitet të kryer nga komuna që në mënyrë direkte apo indirekte ndikon në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Po ashtu, të sinjalizohet niveli qendror në mënyrë të vazhdueshme për problemet që mund ti shkaktohen komunës me ndotjen e ajrit nga veprimtaria e ndotësve të mëdhenj të ajrit.  | Komunat (Prishtina, Mitrovica, Obiliq, Hani i Elezit dhe Gjilan) | Nuk ka përgjigje |
|   | Të ndaj përgjegjësit dhe të definojë qartë institucionet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave për marrëveshjet e bashkëfinancimit, në mënyrë që të kemi një raportim në nivel shtetëror mbi gjendjen e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëfinancimit dhe marrëveshjeve tjera financiare.   | Qeveria e Kosovës  | Nuk ka përgjigje |
| Menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura            | Në cilësinë e sekretariatit duhet të sigurojë koordinimin e institucioneve për marrëveshjet ndërkombëtare në mënyrë që të gjitha projektet të financuara nga donatorët të jenë në harmoni me programet qeveritare sipas sektorëve të caktuar   | MIE (tani pjesë e ZKM)   | Nuk ka përgjigje |
|   | Të përgatitë modele praktike në mënyrë që të shërbejë si udhëzues për të gjitha ministrin për përgatitjen e projekt propozimeve për financim. Këto modele do të sigurojnë se projektet e financuara nga donatorët janë identifikuar dhe rishikuar përmes akterëve përgjegjës në mënyrë që të jenë në harmoni me prioritetet qeveritare dhe mos dyfishimit të tyre.   | MIE (tani pjesë e ZKM)   | Nuk ka përgjigje |
|   | Të hartoj dhe nxjerr rregullore mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të grupeve punuese, të organizoj takime të rregullta, të përgatit raportet dhe prezantimet për prioritetet e Republikës së Kosovës.   | MIE (tani pjesë e ZKM)   | Nuk ka përgjigje |
|   | Të sigurojë koordinimin e një Sistemi të Integruar të Monitorimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha ministrin duke demonstruar realizimin e aktiviteteve në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe zotimet e bëra nga të dy palët. Një raport i tillë do të sigurojë Qeverisë që këto ndihma të jenë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore, si dhe të jenë të ndërlydhura sa më shumë që është e mundur me dokumentet strategjike në mënyrë që të arrihet efektivitet më i lartë i këtyre ndihmave. | MIE (tani pjesë e ZKM)   | Nuk ka përgjigje |
|   | Të sigurojë koordinimin e një Sistemi të Integruar të Monitorimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha ministrin duke demonstruar realizimin e aktiviteteve në përputhje me objektivat e përcaktuara dhe zotimet e bëra nga të dy palët. Një raport i tillë do të sigurojë Qeverisë që këto ndihma të jenë në harmoni të plotë me prioritetet zhvillimore, si dhe të jenë të ndërlydhura sa më shumë që është e mundur me dokumentet strategjike në mënyrë që të arrihet efektivitet më i lartë i këtyre ndihmave. | MIE (tani pjesë e ZKM)   | Nuk ka përgjigje |

|  |                         |                  |
|--|-------------------------|------------------|
| Implementuesit e projekteve të KRU "Hidroregjioni jugor" në Prizren dhe KRU "Hidromorava" në Gjiilan në bashkëpunim me Komunën të realizojnë objektivat e tyre për marrëveshjen me qytetarët për ndërtimin e impianteve të ujërave, sensibilizimin e banorëve për kyçje në rrjetin e ujësjellësi   | KRU Hidroregjioni jugor | Nuk ka përgjigje |
| Implementuesit e projekteve të KRU "Hidroregjioni jugor" në Prizren dhe KRU "Hidromorava" në Gjiilan në bashkëpunim me Komunën të realizojnë objektivat e tyre për marrëveshjen me qytetarët për ndërtimin e impianteve të ujërave, sensibilizimin e banorëve për kyçje në rrjetin e ujësjellësi   | KRU Hidromorava         | Nuk ka përgjigje |
| KRU "Hidroregjioni jugor" në Prizren të bashkëpunojnë dhe koordinojnë aktivitetet e tyre për udhëheqjen e procedurave të prokurimit me partnerin implementues CDI.   | KRU Hidroregjioni jugor | Nuk ka përgjigje |
| KRU "Hidromorava" në Gjiilan të dizajnojë dhe të vendosë një sistem përmes së cilit do të prodhojë raporte periodike që ofrojnë informata të sakta, relevante dhe në kohë lidhur me progresin drejt arritjes së planit të paraparë, në mënyrë që të rrisë llogaridhënien për burimet e përdorura dhe për rezultatet e arritura.                  | KRU Hidromorava         | Nuk ka përgjigje |
| Komuna e Fushë Kosovës në të ardhmen të sigurojë implementimin e projekteve bazuar në objektivat e programit. Kontratat të nënshkruhen bazuar në procedura të hapura dhe transparente. Si dhe praktikat e deritanishme të bartjes së mjeteve për realizimin e projekteve me donatorët të ndërpriten duke ju shmangur keq përdorimeve të mundshme | Komuna e Fushë Kosovës  | Nuk ka përgjigje |





Zyra Kombëtare e Auditimit | Lagjja Arbëria | Rr. Ahmet Krasniqi, 210 | 10000 Prishtina  
Republika e Kosovës



Republika e Kosovës